



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PREFEKTI I QARKUT FIER

# ANALIZA VJETORE 2022



26 Janar 2023



[Prefekti.Fier@mb.gov.al](mailto:Prefekti.Fier@mb.gov.al)



<http://prefektifier.gov.al/>

## PËRMBAJTJA

<b>I. RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT .....</b>	<b>4</b>
STRUKTURA ORGANIKE E ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT QARKU FIER. ....	6
BUXHETI I INTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER .....	8
ARKIVIMI I DOKUMENTACIONIT .....	12
<b>II. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE .....</b>	<b>13</b>
VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES .....	14
VERIFIKIMI NË VEND I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE.....	17
<b>III. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME DEGËT TERRITORIALE DHE INSTITUCIONET .....</b>	<b>22</b>
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, FIER, LUSHNJË, MALLAKASTËR .....	22
DREJTORIA VENDORE E POLICISË .....	23
INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT .....	24
DEGA E DOGANËS FIER.....	26
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT FIER .....	27
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK FIER .....	29
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE.....	30
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, FIER .....	32
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, FIER .....	34
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, GJIROKASTËR .....	34
OSHEE DREJTORIA RAJONALE.....	36
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER.....	38
AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR LUSHNJË .....	39
SEKTORI I BORDIT TË KULLIMIT .....	45
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT, FIER .....	45
DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL, FIER.....	47
NJËSITË VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR.....	47
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR .....	54
ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TË MBROJTURA .....	55
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT, FIER.....	58

<b>IV. MBROJTJA CIVILE.....</b>	<b>77</b>
<b>V. TASK FORCA, KOMITETET RAJONALE SI DHE ORGANI KËSHILLUES PRANË PREFEKTIT TË QARKUT .....</b>	<b>86</b>
KOMITETI RAJONAL I TURIZMIT .....	86
VEPRIMTARIA E TASK-FORCE “ PËR LUFTËN KUNDËR KANABISIT”. .....	87
ANTITRAFIKIMI E PERSONAVE NË QARKUN FIER ( KRAT ) .....	88
<b>VI. REKOMANDIME.....</b>	<b>93</b>
<b>VII. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023 .....</b>	<b>94</b>
<b>VIII. BURIMI I INFORMACIONIT.....</b>	<b>97</b>

## **I. RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT**

Në veprimtarinë e tij të punës një-vjeçare, institucioni i Prefektit të qarkut Fier ka funksionuar dhe ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, me aktet ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrive të linjës, në drejtim të garantimit të zbatimit të programit të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive gjatë vitit 2022, u fokusua jo vetëm në forcimin e rritjes së rolit të Institucionit bazuar në ligjin për Prefektin e Qarkut, por edhe në forcimin dhe bashkëpunimin real me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Degët Territoriale, Policinë Vendore, në punën për kapërcimin e situatës së pandemisë të krijuar nga Covid 19, përballimit të Emergjencave Civile në Bashkëpunim me strukturat e Mbrojtjes Civile në NJVQV e Qarkut dhe sidomos të marrëdhënieve me Qytetarin. Viti 2022 u konsiderua si viti i vijimësisë së standardizimit, funksionimit të qasjes së re të marrëdhënieve midis Institucionit të Prefektit të Qarkut në raport me Ministrinë dhe Institucionet e tjera Qendrore, me Degët Territoriale që veprojnë në qark dhe NJVQV, në dy drejtime:

në zbatimin me përpikmëri të Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, ligj i cili ka përcaktuar rolin e prefektit si përfaqësues të Këshillit të Ministrave në qark, si garantues i zbatimit të programit të qeverisë në nivel qarku, përgjegjësitë dhe kompetencat e tij për realizimin e këtij misioni;

-Programi i Qeverisë 2021-2025 në zbatimin e tij, kërkon impenjim, bashkëpunim, koordinim maksimal të këtij institucioni për zbatimin me sukses të reformave të miratuara, si dhe për arritjen e objektivave të vendosura nga qeveria Rama 3..

Institucioni i Prefektit qarku Fier gjatë vitit 2022, ka ndjekur, monitoruar e shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor, duke bashkërenduar punën, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; ka rritur kërkesat ndaj vetes dhe Institucioneve në fjalë duke intensifikuar punën dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me Njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të qarkut, nëpërmjet shkëmbimeve shkresore, takimeve me drejtues të institucioneve dhe drejtues të NJVV, ndjekjen e problematikave dhe jo vetëm, me qëllim krijimin e urave bashkëpunuese dhe ndërvepruese për zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë kësaj periudhe.

Gjatë vitit 2022, institucioni i Prefektit të qarkut, duke rritur kërkesat për standard ndaj vetes si Institucion, ka intensifikuar punën në bashkëpunimin real dhe konkret me strukturat përkatëse për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Institucioni i Prefektit të qarkut ka bashkërenduar dhe ka siguruar mbështetjen e ndërsjellët të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe të organeve të Vetëqeverisjes Vendore, për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku.

Në fillim të vitit 2022, janë hartuar planet vjetore sektoriale të punës dhe janë përcaktuar objektivat e institucionit të Prefektit të qarkut.

Në muajin janar të vitit 2022 është hartuar dhe miratuar plani vjetor i punës së institucionit të Prefektit të qarkut si dhe janë përcaktuar prioritetet dhe objektivat e sektorëve dhe të gjithsecilit për realizimin me sukses të të gjithë veprimtarisë së institucionit.

Bazuar në urdhërin 50 të Kryeministrit u hartua për çdo sektor harta e proceseve, regjistri i Riskut dhe u zbatuan detyrat e lëna nga Kontrolli i Auditit të Ministrisë së Brendshme

Gjatë vitit 2022, me prioritet të veçantë janë trajtuar dhe ndjekur të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të adresuara pranë Prefektit të qarkut. Problematikat dhe shqetësimet e qytetarëve kanë pasur të bëjnë me shërbime të ndryshme dhe detyrime për organet e vetëqeverisjes vendore dhe një numër i konsiderueshëm i tyre për institucionet rajonale vendore.

Një nga shërbimet që institucioni i Prefektit ofron për qytetarët është legalizimi i dokumenteve të lëshuara për përdorim jashtë vendit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në total përgjatë vitit 2022 numri i legalizimeve ka qenë **18116** copë.

Gjatë vitit 2022, në Protokollin e institucionit të Prefektit janë përpunuar në total **1326 shkresa**, dhe protokolluar gjithsej 31 urdhëra të Prefektit

Një vëmendje e veçantë iu është kushtuar ankesave të qytetarëve, të cilat i janë adresuar për zgjidhje njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Nga të gjitha ankesat e trajtuara, të cilat lidhen me ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo vendimmarrjen e këshillave bashkiakë, vihet re se një pjesë e mirë e tyre kanë marrë zgjidhjen ligjore, por kërkohet një angazhim më i madh nga ana jonë për rritjen e shërbimit ndaj komunitetit, duke ndjekur rrugën deri në dhënien e zgjidhjes përfundimtare të problematikave të tyre nga ana e Institucioneve përgjegjëse.

Prefekti i qarkut organizoi takim me kryetarët dhe nënkryetarët e bashkive edhe mbi bashkëpunimin mes institucionit të Prefektit të qarkut dhe njëjësive të vetëqeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Saj koordinimit të bërë nga institucioni i Prefektit gjatë sezonit pranverë – verë është rritur ndjeshëm **bashkëpunimi** i strukturave operacionale në nivel vendor ( MZSH-të) duke i ardhur në ndihmë njëra – tjetrës për përballimin e situatave të shkaktuara nga zjarret gjatë periudhës së verës, në veçanti strukturat e MZSH-së Roskovec dhe Patos, në mbështetje të strukturave të bashkive të tjera. Prefekti në kuadër të koordinimit dhe bashkëpunimit efektiv ka zhvilluar me strukturat vendore të Mbrojtjes Civile përgjatë sezonit pranverë- verë 6 takime me fokus rritjen e gatishmërisë dhe të bashkëpunimit midis strukturave apo edhe çështje të tjera mbi përballimin e situatës së nxehtë të verës. Ka kryer vizita inspektuese në 5 stacionet e shërbimit zjarrfikës në bashkitë e qarkut Fier. Duke vlerësuar rëndësinë e situatës ka marrë pjesë drejtpërdrejtë në 11 ngjarje emergjente. Nën koordinimin e Prefektit, referuar kërkesës së bashkisë Patos, kemi angazhuar në një rast forcat operacionale të bashkive të qarkut fqinj, Berat me dy mjete zjarrfikës dhe 10 efektivë si dhe në nivel qendror angazhimin e një helikopteri të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Janë organizuar 3 mbledhje të Komisionit të Mbrojtjes Civile , Qarku Fier, si struktura vendore kryesore në fushën e mbrojtjes civile. Gjithashtu, me krijimin e grupit të Whatsapp-it

“ Komisioni i MC, Fier 2022” është standardizuar dhe strukturuar mënyra e raportimit mbi situatat emergjente në nivel qarku.


**STRUKTURA ORGANIKE E ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT QARKU FIER.**

Për administratën e Prefektit Qarkut për vitin 2022 nuk ka ndryshuar plani i strukturës organike, nga ajo e vitit 2016.

Është në fuqi struktura e ardhur me Urdhër të Kryeministrit Nr. 4 Datë 12.01.2016 e ndërtuar në Sektorë dhe që ka një organikë prej 29 punonjësish.

Si funksion i deleguar është vetëm Arkivat e Gjendjes Civile në Fier dhe dy Nënprefekturat me 3 nëpunës gjithsej.

**Struktura e Administratës së Prefektit të Qarkut, është si më poshtë:**



Struktura organike e Institucionit të Prefektit Qarku Fier ka ndikuar në mos realizimin e buxhetit, për arsye të mbetjes së vendeve vakante për një kohë të gjatë. Gjatë vitit 2022 kanë qenë 5 vende vakante nga 1 janari, 4 në shërbimin civil dhe 1 funksionar politik dhe në fund të vitit mbetet 1 vakancë nëpunës civil në sektorin e emergjencave civile dhe një funksionar politik Nënprefekti Lushnje.

Më konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i Personelit	Plan	Fakt	Vakant
1	Numri i pozicioneve sipas strukturës së miratuar	32	30	2
	Nga të cilët			
2	Numri i pozicioneve të funksionarëve politik sipas strukturës	3	2	1
3	Numri i nëpunësve civil	23	22	1
4	Numri punonjësve mbështetës	3	3	0
5	Numri gjithsej i punonjësve për funksionet e deleguara	3	3	0
6	Numri i Vendeve Vakante të Shërbimit Civil			<b>1</b>

**Emëruar nga procedura e lëvizjes paralele:** 0 nëpunës civil.

**Larguar nga procedura e lëvizjes paralele:** 0 nëpunës civil.

**Emëruar nga procedura e pranimit në shërbim civil:** 1 nëpunës civil në periudhë prove.

**Emërim nga VKM për punësimin e ekselentëve:** 3 nëpunës.

**Dorëheqje:** 1 nëpunës (emëruar nga ekselencia).

**Lirim nga detyra:** 0

**Morën statusin e nëpunësit civil:** 5 nëpunës.

Prioritet i punës për vitin 2022 ishte plotësimi i vendeve vakante, sipas thirrjes së kryeministrit për punësimin e studentëve ekselent, sipas aftësive profesionale dhe kriterëve të përcaktuara, në aktet ligjore, nënligjore në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, Ministrinë e Brendshme, dhe plotësimi vazhdimisht i ndryshimeve në regjistrin elektronik të punonjësve (HRMIS).

Mosmiratimi i strukturës së re, të propozuar nga Prefektët e Qarqeve, nga Ministria e Brendshme dhe Qeveria, sjell një dobësim të autoritetit të institucionit të Prefektit, për ushtrimin e funksioneve të tij, ndaj njësisve vendore, dhe ndaj prioriteteve të politikës qeveritare.

## BUXHETI I INTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER

**Buxheti total i planifikuar për vitin 2022 është 34640 mijë lekë**

Të ndara sipas programeve:

Administrata e Prefektit, 31301 mijë lekë.

Gjendja civile, si funksion i deleguar 3339 mijë lekë.

Të ndara sipas llojit të shpenzimeve:

Paga, shpërblime, të tjera shpenzime personeli 22796 mijë lekë ( 66%).


Kontributi i sigurimeve shoqërore 4516 mijë lekë (13 %).

Mallra & shërbime të tjera (shpenzime operative) 6568 mijë lekë (18.9 %).

Transferta tek individët 560 mijë lekë (1.6 %).

Shpenzime për investime 200 mijë lekë ( 0.5.) %

Në mënyre grafike, pesha specifike e zërave të buxhetit ndaj totalit, paraqitet si më poshtë:






**Realizimi i buxhetit. në 000 lekë**

Realizimi sipas shpenzimeve programeve paraqitet	Artikulli	Struktura Buxhetore	Buxheti		Realizimi	Diferenca	Realizimi ndaj planit/ndryshime %
			Plani Fillestar 01.01.2022	Planëzime ndryshime 31.12.2022			
	600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	22 056	20 296	19 359	937	95%
Prefekti	601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4 213	4 103	3 217	886	78%
	602	Mallra dhe shërbime të tjera	7 012	6 172	5 912	260	96%
	606	Transferta tek individët	0	530	530	0	100%
	231	Investim Pajisje zyre		200	191	9	96 %
		<b>Shuma në mijë/lekë Prefekti</b>	<b>33 281</b>	<b>31 301</b>	<b>29 209</b>	<b>2 092</b>	<b>93,3%</b>
	600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	2 200	2 500	2 458	42	98%
Gj. Civile	601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	365	413	410	3	99%
	602	Mallra dhe shërbime të tjera		396	126	270	32%
	606	Transferta tek individët	0	30	30	0	100%
		<b>Shuma në mijë/lekë, GJ.Civile</b>	<b>2 565</b>	<b>3 339</b>	<b>3 024</b>	<b>315</b>	
		<b>Totali</b>	<b>35846</b>	<b>34 640</b>	<b>32 233</b>	<b>2 407</b>	<b>93%</b>

**Në total për secilin artikull për të dy programet:**

Artikulli	Struktura Buxhetore	Buxheti	Realizimi	Diferenca	Realizimi në %
600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	22796	21817	979	96 %
601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësorë	4516	3627	889	80 %
602	Mallra dhe shërbime të tjera	6568	6038	530	92 %
606	Transferta tek individët	560	560	0	100%
231	Investim pajisje Zyre	200	191	9	96%
	<b>TOTALI</b>	<b>34640</b>	<b>32233</b>	<b>2407</b>	<b>93 %</b>

Në mënyre grafike, realizimi i shpenzimeve faktike, ndaj planit buxhetor, paraqitet si më poshtë:



Në total buxheti vjetor është realizuar në masën 93% .

Shpenzimet për paga, shpërblime, shpenzime personeli janë realizuar 96 %

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 80 %.

Mallra dhe shërbime të tjera, 92 %.

Transferta tek individët, 100 %.

Investim pajise zyre, 96 %.

Përsa i përket realizimit të fondit të pagave në masën 96% vjen si rezultat i plotësimit të vendeve vakante.

Shpenzimet për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë realizuar në masën 80%, që vjen si rezultat i mos ndryshimit të planit fillestar të fondit për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore gjatë vitit 2022.

Përsa i përket realizimit 92 % **të planit me ndryshime** në artikullin 602 mallra dhe shërbime me diferencë në vlerë absolute me 530 mijë lekë, vlen të theksojmë se kjo ka ardhur si rezultat i kursimeve dhe miradministrimit të shërbimeve si uji, energjia, shpenzimet postare, shërbime telefonike etj. Mosrealizimit të shpenzimeve operative për programin e Gjendjes Civile për lidhjen e akteve të nxjerra nga aktiviteti i saj nga 396 mijë plani u realizua në 126 mijë lekë në muajin dhjetor. Për më tepër fondi ishte me destinacion të veçantë dhe nuk kishte mundësi praktike dhe kohe për tu realizuar plotësisht. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për periudhën 1 vjeçare ka realizuar mirë objektivin në përdorimin e fondeve buxhetore me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet.

-Realizimi i shpenzimeve **për paga** për periudhën 1-vjeçare është në masën 96%.

Buxheti fillestar i vitit 2022 është në vlerën 35.846.000 lekë dhe në fund të vitit 2022 plani i buxhetit ka pësuar rënie me pakësim të fondeve buxhetore në vlerën 34.640.000 lekë me një diferencë 1.206.000 lekë më pak. Pakësimi i fondeve vjen nga pakësimi i fondit të pagave, nga 24.256.000 në 22.796.000 në vlerë absolute pakësim në vlerën 1.435.744 lekë, pakësim i shpenzimeve për sig. shoqërore në vlerën 110.000 lekë, shpenzime operative në vlerën 444.000 lekë në vlerë absolute.

Menaxhimi Financiar për periudhën njëvjeçare 2022 ka një shfrytëzim maksimal të fondeve buxhetore për shpenzimet operative në masën 92%..

***Kjo tregon se Sektori i Financës ka ndjekur me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet përdorimin e fondeve buxhetore për kryerjen e aktivitetit normal të institucionit.***

Ne vijim të kërkesave për fonde është risi një shtesë fondi vetëm për programin e gjendjes civile.

Ka bërë të mundur shtesë në akordimin e fondeve buxhetore në shpenzime operative për funksionin e deleguar të gjendjes civile si u përmend edhe më lart në vlerën 396.000 lekë për lidhjen e akteve të gjendjes civile si edhe përballimin e transportit duke shfrytëzuar makinat në pronësi të Institucionit, paga sig. shoqërore 368000 lekë.

### **Realizimi i të Ardhurave**

Të vetmet të ardhura të krijuara gjatë vitit janë të ardhurat e Gjendjes Civile nga taksat e pullave si funksion i deleguar në Institucionin e Prefektit të Qarkut dhe veprimet si agjent tatimor ku 95% kalojnë nëpërmjet DPT-së në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit dhe vetëm 5% i takojnë institucionit që vepron si agjent tatimor përkatësisht Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Krahasuar me vitin 2021 kemi një rritje në vlerë absolute prej 164.100 lekë në total.

Në shërbim të rritjes së imazhit të institucionit, ky objektivi është realizuar më mirë në menaxhimin e burimeve financiare dhe përmirësimin e kushteve të punës duke bërë të mundur përdorimin e tyre me efektivitet. Për vitin 2022 si 12 mujor është realizuar prokurimi "Kancelari" dhe "Materiale Pastrimi", siguracione të mjeteve të transportit, shërbime të ndryshme, taksa të mjeteve të transportit, shlyerja e detyrimeve për të tretët për faturat utilitare energji, postë, po ashtu interneti, shërbimi i rojeve private, lidhja e akteve të gjendjes civile për një periudhë 4 vjeçare etj.

Në vijim të kërkesave për fonde është risi një shtesë fondi vetëm për programin e gjendjes civile për pagat dhe sigurimet shoqërore si rezultat i ndryshimit të kategorisë.

### **Është ulur konsumi i karburantit për makinat e institucionit.**

Për vitin 2021 konsumi i karburantit ishte 3636 litra ndërsa për vitin 2022 është 2370 litra pra kemi një kursim të karburantit me një diferencë prej 1266 litra, pra një konsum mujor prej 197.5 litra pra 99 litra mesatarisht për një makinë në muaj.

- Është bërë i mundur akordimi i fondit për investime në vlerën 200 000 lekë për blerjen e dy printërave fotokopje skaner për institucionin dhe është bërë blerja nëpërmjet prokurimit brenda muajit dhjetor 2022 në vlerën 191000 lekë. Është ndjekur në vazhdimësi regjistri i prokurimeve dhe janë realizuar prokurimet e planifikuara. Është siguruar pa asnjë mungesë baza materiale e domosdoshme për kryerjen e aktivitetit të institucionit, si edhe kryerja e shërbimeve për mjetet e transportit dhe shërbimeve të tjera si ai i ruajtjes së objektit etj. Arritje dhe efikasitet kemi në përdorimin e fondeve për energjinë elektrike në mbështetje të Aktit Normativ Nr.14, datë 05.10.2022 "Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike". Kemi kursim deri 16% të konsumit të energjisë elektrike në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021. Rreth 4260 KW nga 15% që ishte objektivi sipas Aktit Normativ, pra e kemi tejkaluar objektivin si institucion .

Është implementuar në gusht të vitit 2022 sistemi AFMIS për kalimin online të aktivitetit financiar të institucionit. është duke vazhduar praktika e sistemimit të pronave të Lushnjës, godinës së Institucionit në inventar të ish-nënprefekturës, si rrjedhojë në inventar të Institucionit të Prefektit Qarkut Fier, pra të statusit juridik të pronës me statusin e përdoruesit në fakt nga disa institucione të tjera si Bashkia Lushnje, Instat-i, DAMT, ish të përndjekurit politik, pasi ka filluar procedurat me ASHK për ndarjen e pronës.

## **ARKIVIMI I DOKUMENTACIONIT**

**Arkivimi i dokumentacionit, standardizimi i mënyrës së hartimit të shkresës, urdhrimit dhe trajtimit të kërkesave dhe ankesave, dorëzimit të dokumentacionit të prapambetur në AQV, ruajtja e dokumenteve shkresore, monitorimi i ecurisë së sistemit të dokumentacionit arkivor në vite.**

Është bërë standardizimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier

Është punuar për Standardizimin e mënyrës së hartimit të urdhrimit, vendimit, udhëzimit, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, kthim përgjigjeve dhe arkivimit pas përfundimit të praktikave të ndryshme për përmirësimin e punës në institucion.

Është konceptuar shkresa duke zbatuar me rigorozitet gjuhën shqipe dhe përmirësimin e mënyrës së formulimit të dokumentit.

Është bërë përmirësimi i kushteve të ambientit të përpunimit të dokumentacionit shkresor ditor të arkivit. Është shoqëruar çdo shkresë me kartelën shoqëruese. Është hartuar pasqyra emetuese e çeljes së dosjeve për dokumentet me afat ruajtje RHK dhe jo RHK.

Kryerja çdo ditë e Regjistrimit të korrespondencës, standardizimit të praktikave të shkresave zyrtare që prodhon institucioni, pajisja e shkresave hyrëse me kartelë shoqëruese, evidentimi, përpunimi, shpërndarja dhe protokollimi i shkresave që hyjnë dhe dalin nga Institucioni, si dhe shkresave që lëvizin brenda Institucionit,

Dorëzimi bëhet sipas kalendarit të miratuar nga DPA.

#### **-Përsa i përket arkivës:**

*-Arritje ka në standardizimin e shkresave që hyjnë dhe dalin nga institucioni;*

*-Pajisja me kartelë shoqëruese e shkresave hyrëse në institucion, duke mundësuar një mënyrë më institucionale të njohjes me shkresat dhe duke eliminuar shkarravitjen me shënime të shkresës që përcillej nga institucionet e tjera;*

*-Njësimi i dokumentit administrative me urdhërin nr. 06 datë 12.01.2022 të Prefektit, duke i shtuar elementë të munguar shkresës dhe duke e përmirësuar formën dhe duke e kthyer njëkohësisht protokollin në një filtër për shkresat që dalin nga institucioni dhe nuk janë në përputhje me urdhërin e sipërpërmendur.*

*-Hartimi i pasqyrës emërtuese të çeljes së dosjeve, i cili mundëson një organizim të arkivës duke lehtësuar punën e specialistes dhe njëkohësisht mundëson aksesin e shpejtë të shërbimit arkivor për të gjithë kërkesat e institucionit.*

*-Eliminimi i prapambetjes arkivore duke realizuar dorëzimin e vitit 1999 dhe 2000 dhe duke bërë gati për dorëzim vitin 2001 dhe hedhja në faqen e DPA në adresën Web: [katalogu.arkiva.gov.al](http://katalogu.arkiva.gov.al)*

## **II. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**


Marrëdhëniet midis Prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore përcaktohen në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e qarkut” dhe në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërmjet Prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie. Marrëdhëniet ndërmjet Prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

## VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE QË JANË DEPOZITUAR NË ZYRËN E PROTOKOLLIT TË INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT

Në zbatim të kompetencave që i njej ligji 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, Prefekti i qarkut Fier edhe gjatë vitit 2022 ka realizuar procesin e verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore duke zbatuar procedurën e parashikuar në nenin 16 të ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut”. Për të gjitha vendimet e depozituara pranë zyrës së protokollit të institucionit të Prefektit është bërë verifikimi dhe është formuluar shkresa përcjellëse me pasqyrimin e argumentimit ligjor për konfirmimin ose jo të këtyre akteve brenda afateve ligjore.

Për periudhën janar-dhjetor 2022 nga gjashtë njësi të vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë dhe një njësi e vetëqeverisjes vendore e nivelit të dytë Këshilli i Qarkut Fier, në Institucionin e Prefektit të Qarkut janë depozituar dhe **shqyrtuar për vlefshmëri ligjore 107 vendime** me karakter normativ të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. **Janë verifikuar në përputhje me ligjin 101 vendime të këshillave. Janë kthyer jo në përputhje me ligjin 5 vendime, 1 vendim i këshillit bashkiak Roskovec është dërguar në gjykatë për pavlefshmëri ligjore.** Vendimet e kthyer jo në përputhje me ligjin kanë pasur si shkak kryesisht shkeljen e ligjit material nga këshilli bashkiak.



Vendimet me karakter normativ kanë qenë me natyrë kryesisht financiare si ndryshime të buxhetit, paketës fiskale, rishpërndarje fondesh në buxhet, miratimi i shtesave të fondit të buxhet, miratimi i kriterëve apo standardeve që lidhen me funksionet që i kanë kaluar këshillit, përdorimi i fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, miratimin e PBA-së në të gjitha fazat e saj.

Krahasimisht me vitin 2021 vihet re një numër më i vogël aktesh të paraqitura nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, por gjithashtu edhe një përqindje më e vogël e akteve të kthyer të pakonfirmuara. Ne vitin 2021 nga totali i akteve të paraqitura për konfirmim nuk janë konfirmuar 13% e akteve, ndërsa në vitin 2022 nuk kanë marrë konfirmimin e Prefektit 4.67% e akteve të paraqitura.

Pasqyra e akteve normative të NJVQV-ve për vitin 2022 është si më poshtë:

Nr.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të organeve të qeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pa bazuara ne ligj		Të rishqyrtuara nga QQV		Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve		Dërguar në gjykatë		Vendime të pa konfirmuara, në proces për kërkim informacioni	
		Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog
1	Keshilli i Qarkut Fier	0	9	0	9	0	0	0	0	0	6	0	0	0	0
2	Bashkia Fier	0	18	0	18	0	0	0	0	0	15	0	0	0	0
3	Bashkia Patos	0	13	0	12	0	1	0	0	0	12	0	0	0	0
4	Bashkia Roskovec	0	23	0	19	0	3	0	0	0	19	0	1	0	0
5	Bashkia Mallakastër	0	12	0	12	0	0	0	0	0	10	0	0	0	0
6	Bashkia Lushnje	0	19	0	18	0	1	0	0	0	15	0	0	0	0
7	Bashkia Divjakë	0	13	0	13	0	0	0	0	0	10	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>0</b>	<b>107</b>	<b>0</b>	<b>101</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>87</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Për të gjitha vendimet e depozituara nga NJVQV-të është bërë verifikimi ligjor i thelluar dhe sipas rastit nga sektori juridik është formuluar shkresa përcjellëse me pasqyrimin e argumentimit ligjor për konfirmimin ose jo të këtyre akteve brenda afateve ligjore.

Për sa i përket vendimeve me objekt përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, janë verifikuar në bashkëpunim me sektorin e emergjencave civile si sektor mbështetës.

Bashkia me numrin më të madh të akteve normative të depozituara për verifikim ligjor është bashkia Roskovec, me 23 vendime me karakter normativ ndërsa Këshilli i Qarkut rezulton me numrin më të vogël 9 vendime me karakter normativ. Gjithashtu bashkia Roskovec është bashkia me numrin më të lartë të vendimeve të kthyera në kundërshtim me ligjin me gjithsej 3 vendime.

**Këshilli i Qarkut Fier, Bashkia Fier, Bashkia Divjakë dhe Mallakastër nuk kanë vendime të kthyera.**

Kurse njësitë e tjera janë si më poshtë:

Bashkia Lushnje me 1 vendim.

Bashkia Patos 1 vendime. .

Bashkia Roskovec 3 vendime.



Në çdo rast të kthimit të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, nga ana jonë është bërë argumentimi ligjor i papajtueshmërive të konstatuara. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me sekretarët e këshillave të bashkive por edhe me specialistët sipas kërkesave në funksion të përmirësimit të punës në lidhje me vendimet e këshillave bashkiakë dhe besueshmërisë së tyre ligjore. Nga ana e sektorit juridik është bashkëpunuar me sekretarët e këshillave, drejtoritë juridike në bashkitë e Qarkut Fier për evidentimin e saktë të akteve me karakter normativ të cilat duhet të depozitohen nga këto të fundit për verifikim ligjor.



Standardizimi i dokumentacionit dhe i procedurave nga NJVQV-të në vendimmarrje ka qenë një sfidë edhe për vitin 2022 e cila ka dhënë edhe rezultatet e saj pozitive. Është punuar shumë në drejtim të dokumentacionit që shoqëron vendimet konkretisht në fillim të verifikimit ligjor, është kontrolluar dokumentacioni standard që shoqëron vendimin projektvendim relacion dhe dëgjuesë publike kur kërkohet nga ligji. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar faktit që dokumentacioni shoqëruar të këtë të gjithë elementet formal që kërkohen nga ligji për arkivat dhe rregullorja e brendshme e këshillit bashkiak. Krahasuar me një vit më parë standardizimi i dokumentacionit nga NJVQV-të ka një ndryshim pozitiv të ndjeshëm që duhet evidentuar. Gjatë vitit 2022 ka më pak vendime të kthyera për plotësim dokumentacioni.

## **VERIFIKIMI NË VEND I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE PRANË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE**

Në zbatim të nenit 17 të Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhrit të Kryeministrit Nr. 50, datë 12.04.2017, “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, si dhe urdhrin të Ministrit të Brendshëm Nr. 175, datë 9.7.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të qarkut” si dhe aneksin 1, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut “është kryer verifikimi në vend i akteve me karakter normativ në mënyrë efektive dhe periodike çdo tre muaj duke garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi përsa i përket verifikimit ligjor të akteve.

Gjatë periudhës janar- dhjetor janë verifikuar gjithsej 87 akte me karakter normativ. Janë zhvilluar gjithsej 4 kontrole. Në muajt mars, qershor, shtator dhe dhjetor 2022.

Kontrolli është përqendruar në veprimtarinë e vendimmarrjes së këshillave bashkiakë/këshillave të Qarkut dhe në verifikimin e akteve me karakter normativ të vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave të organit ekzekutiv, kryetarit të bashkisë. Gjatë verifikimit në vend të akteve me karakter normativ në njësitë e vetëqeverisjes vendore në Qarkun Fier është analizuar dokumentacioni që ndodhej në arkivë për mbledhjet e këshillave bashkiak/këshillit të Qarkut Fier si dhe janë verifikuar aktet e miratuara nga kryetari i bashkisë.

-Dokumentacioni i kërkuar për verifikim ka qenë :

-Rregullore e funksionimit të këshillit të bashkisë/këshillit të qarkut.


-Aktet e këshillit të bashkisë/këshillit të qarkut për periudhën objekt kontrolli

-Aktet e Kryetarit të Bashkisë për periudhën objekt kontrolli

-Libri i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak/këshillit të Qarkut për vitin 2022.

**Nga verifikimi në vend në të gjitha kontrollet periodike që janë kryer në NJVQV-të ka rezultuar se nuk ka akte normative të pa depozituara për verifikim ligjor të Këshillit të Bashkisë/Këshillit të Qarkut si dhe nuk ka akte me karakter normativ të Kryetarit të Bashkisë të pa depozituar për verifikim ligjor.**

## Verifikimi në vend i akteve normative



Gjatë kontrolleve në vend janë evidentuar edhe mangësi të ndryshme dhe janë lënë rekomandime. Nga kontrolli i fundit i zhvilluar në muajin dhjetor rezultoi se nga ana e bashkive ka përmirësim të dukshëm, janë përmbushur pothuajse të gjitha rekomandimet, Bashkitë kanë treguar vullnet dhe bashkëpunim për të korrigjuar mangësitë.

**Zhvillimi i takimeve konsultative me kryetarët dhe sekretarët e këshillave bashkiak si dhe dërgimi i shkresave orientuese për mangësitë e konstatuara gjatë verifikimit ligjor të akteve me karakter normativ.**

Në funksion të përmbushjes së objektivit në datën në dt.14.04.2022 është mbajtur një takim në ambientet e institucionit të Prefektit të Qarkut Fier me pjesëmarrje nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të nivelit të parë dhe të dytë.

Në fokus të takimit ishte Programi Buxhetor Afatmesëm, procedura dhe afatet e miratimit, dokumentacioni që shoqëron këtë vendimmarrje si dhe problematikat e konstatuara gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ.

Në takim morën pjesë kryetarët e këshillave bashkiak, sekretarët e këshillave, sekretari i këshillit të qarkut si dhe koordinatori i projektit “Bashki të Forta” për Qarkun Fier.

Takimi u zhvillua në një frymë bashkëpunimi, me qëllim parandalimin e problematikave në të ardhmen në vendimmarrjen e këshillave vendore si dhe rritjen e standardit juridik të vendimmarrjes. Një vëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimit të konsultimit publik si një proces shumë i rëndësishëm dhe gjithëpërfshirës i komunitetit në vendimmarrje.

Në datën 1 qershor 2022, është zhvilluar në ambientet e Prefektit të Qarkut Fier takimi i organizuar nga Ministria e Brendshme, Projekti Bashki të Forta me pjesëmarrjen e sektorëve juridik të prefekturave Fier, Berat, sekretarëve të këshillave të Qarkut Fier dhe Berat, drejtorive juridike dhe koordinatoreve për

konsultimin publik të bashkive të dy qarqeve lidhur me identifikimin e akteve normative të cilat duhet të depozitohen për verifikim ligjor tek prefekti dhe konsultimin publik të akteve që kërkojnë konsultim. Ne takim u morë si referencë praktika e mirë e Prefektit të Qarkut Fier lidhur me verifikimin e akteve me karakter normativ.



**Në datën 14 korrik** sektori juridik ka marrë pjesë në takimin konsultativ online me projektin Bashki të Forta për hartimin e dokumentit që vlerëson procesin e konsultimit publik dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrjen vendore në kuadrin e procesit të hartimit nga Qeveria Shqiptare të strategjisë për decentralizim dhe vetëqeverisje vendore 2023-2030 ku sektori juridik ka parashtruar një sërë opsionesh se si mund të përmirësohet procesi i konsultimit publik nëpërmjet përmirësimeve të mundshme ligjore.



**Në datën 7 tetor 2022 në ambientet e Institucionit të Prefektit** është zhvilluar takimi me objekt “Buxhetimi me pjesëmarrje si shprehje e demokracisë direkte”. Takimi u organizua nga Qendra Rinore e Vlorës, me pjesëmarrjen e një grupi miks nga Ministria e Brendshme. ( Drejtoria për Koordinimin dhe Monitorimin e Prefekturave ) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga

njësitë e qeverisjes vendore, përgjegjëse për procedurat e buxhetimit , administrata e bashkive edhe nga këshillat bashkiak respektiv, prefekti i qarkut sekretari i përgjithshëm, sektori juridik dhe i financës i institucionit të prefektit. Qëllimi i trajnimit ishte rritja e kuptueshmërisë mbi rëndësinë e buxhetimit me pjesëmarrje dhe udhëzimi për zbatimin në praktikë të kësaj mënyre të re buxhetimi.



**Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi objektiv vjetor.**

Gjatë vitit 2022 kemi patur 2 procese gjyqësore.

Procesi i parë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me palë paditëse Prefektin e Qarkut Fier, palë të paditur Këshillin e Bashkisë Roskovec, Bashkinë Roskovec dhe palë të tretë Avokaturën e Shtetit. me objekt padie: “Deklarimin e pavlefshmërisë së aktit nënligjor normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, vendimit Nr. 21, datë 29.03.2022 “Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 ‘Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” dhe Shfuqizimin tërësisht të vendimit Nr. 21, datë 29.03.2022 “Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 ‘Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”. Me autorizim Prefekti i Qarkut Fier është përfaqësuar nga përgjegjësia e sektorit juridik dhe specialist Pëllumb Feneri.

Kjo padi është shqyrtuar në themel me trup gjykues të përbërë nga 5 anëtar sipas ligjit Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Nga ana e sektorit juridik janë përgatitur pretendimet, diskutimi përfundimtar dhe të gjitha materialet e tjera të kërkuara nga gjykata. Aktualisht jemi në proces pritje me njohjen e vendimit nga ana e gjykatës. Procesi i dytë në Gjykatën Administrative të shkallës së parë me palë paditëse Z. Enver Kasaj, i paditur: Prefekti i Qarkut Fier, Person i tretë: Avokatura e shtetit Zyra Vendore Vlorë

**Objekti:** “Detyrimin e institucionit te Prefektit të Qarkut Fier për të trajtuar financiarisht paditësin Enver Kasaj me shpërblim të menjëhershëm në masën e dy pagave referuese mujore dhe pagesë kalimtare në masën 50 për qind të pagës referuese mujore për një periudhë 24 (njëzetë e katër) mujore, sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të forcave të armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo çështje është ende në fazën e veprimeve përgatitore, gjykata dhe nuk ka vendosur një date për procesin gjyqësor.

Gjatë muajit shtator në zbatim të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave për heqjen dorë nga rekursi e depozituara nga administrata shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave të pashqyrtuara nga Gjykata e Lartë, për disa çështje me natyrë civile dhe administrative” sektori juridik ka hartuar kërkesat për heqje dorë nga rekursi i bërë në Gjykatën e Lartë për 12 paditës të cilët kanë fituar procesin gjyqësor me institucionin e Prefektit bëhet fjalë për padi pune. Heqja dorë ka nga rekursi është bërë në zbatim të Udhëzimit Nr. 1 datë 26.05.2022 dhe K.Pr.Civile pasi përmbushja e detyrimit nga institucioni ka qenë në vlerë më të vogël se dyzetë fishi i pagës minimale në shkallë vendi”. Për procedurën e ndjekur është informuar Ministria e Brendshme. Aktualisht Gjykata e Lartë është shprehur për disa nga kërkesat tona për heqje dorë nga rekursi duke i pranuar ato.

### III. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME DEGËT TERRITORIALE DHE INSTITUCIONET SHETËTËRORE NË NIVEL VENDOR

Ne varësi të Kryeministrisë janë këto institucione:

#### AGJENCIA SHETËTËRORE E KADASTRËS, FIER, LUSHNJË, MALLAKASTËR

Puna e Drejtorisë Vendore, Fier për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

##### ASHK- FIER RAPORTIMI VJETOR 2022

EMËRTIMI	NR.I PRAKTIKAVE 2022
VKM-827	81
NR. OBJEKTESH ME DOK. TEKNIK TË PËRFUNDUAR DHE VENDIM PER LEGALIZIM (PLANIMETRI, GEN-PLAN)	724
NR. OBJ. TË PARA ME FUNKSION BANIM, TË NDËRTUAR NË TOKË TË VETËDEKLARUESIT	187
AMTP TË REGJISTRUARA PËR HERË TË PARË	1161
CERTIFIKATA PËR TOKËN BUJQËSORE (AMTP TË REJA + TË VJETRA) (pa përfshirë ndarjet e pasurisë, shitjet etj.)	2349

Puna e Drejtorisë Vendore Lushnje përfshirë Bashkinë Lushnje dhe Divjakë për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

ASHK Lushnje Raportimi Vjetor 2022	
EMËRTIMI	NR I PRAKTIKAVE
Nr. i certifikatave	3881
Vendim për legalizim	1048
Vërtetim Pronësie	1635
Nr. i AMTP-ve	696

Të gjitha objektivat dhe pritshmërie për vitin 2022 janë të realizuara.

## **Puna e Drejtorisë Vendore Mallakastër për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:**

<b>ASHK Mallakastër Raportimi Vjetor 2022</b>	
<b>EMËRTIMI</b>	<b>NR I PRAKTIKAVE</b>
<b>Leje Legalizimi</b>	<b>254</b>
<b>Certifikata</b>	<b>63</b>
<b>Nr. I AMTP-ve</b>	<b>172</b>
<b>Ankesa të trajtuara</b>	<b>10</b>
<b>Aplikime të kryera</b>	<b>1790</b>

Janë protokolluar 1060 shkresa, janë kthyer përgjigje Prokurorive, Komisariateve të Policisë, Drejtorive Vendore të Policive, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, etj.

Të gjitha aplikimet për shërbime janë kryer sipas udhëzimit të fundit nëpërmjet e-albania.

### **Në varësi të Ministrisë së Brendshme janë këto institucione**

Drejtoria Vendore e Policisë

Drejtoria Rajonale për kufirin dhe Migracionin

Inspektorati Kombëtar për mbrojtjen e Territorit

### **DREJTORIA VENDORE E POLICISË**

Drejtoria Vendore e Policisë Fier për periudhën Janar-Dhjetor 2022, e orientoi punën e saj bazuar mbi Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021- 2026, dhe aktet normative ligjore që normojnë punën e Policisë së Shtetit.

#### **Prioritetet e këtij institucioni :**

Studimi dhe njohja e dinamikës së kriminalitetit në shkallë qarku

Rendi dhe Siguria Publike, Siguria Rrugore dhe partneriteti me Komunitetin

Rikonceptimi i shërbimeve të Qarkullimit Rrugor, me objektiva dhe parametrat e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Rrugore dhe në përputhje me kushtet konkrete të qarkut tonë

Krimet Kundër Mjedisit, Mbrojtja e Regjimit Juridik të Tokës, si ndërtimet pa leje dhe gjithë gama e krimeve mjedisore,

Lufta kundër paligjshmërisë, në territorin që mbulon DVP Fier, dhe Komisaritet e Policisë

#### **Përmbledhje e kriminalitetit për vitin 2022.**

**Për Janar-Dhjetor të vitit 2022**

janë evidentuar **2166** vepra penale,

zbuluar **2120**, ose **97.8 %**,  
janë implikuar **2309** persona, nga të cilët, janë arrestuar **612**, ndaluar **77**,  
janë ndjekur në gjendje të lirë **1539** dhe janë shpallur në kërkim **81**.

### **Puna e bërë për parandalimin e Kultivimit të bimëve narkotike.**

#### **Gjatë vitit 2022**

Në juridiksionin e Qarkut Fier janë evidentuar **38** raste të kultivimit të bimëve narkotike,  
zbuluar **38**, me zbulueshmëri **100 %**,  
janë implikuar **56** persona nga të cilët **26** janë arrestuar, **1** është ndaluar, **17** janë ndjekur në gjendje të lirë, **12** janë shpallur në kërkim.

#### **Nga sektori i Qarkullimit Rrugor**

janë evidentuar **425** vepra penale  
zbuluar **415**, me zbulueshmëri **97.6 %**,  
janë implikuar **424** persona, nga të cilët,  
janë arrestuar **184**,  
ndaluar **4**,  
janë ndjekur në gjendje të lire **226** dhe për **10** është bërë shpallja në kërkim.

<b>Viti 2022</b>		
<b>Aksidente Rrugore 28</b>		
Vdekur	Plagosur rëndë	Plagosur lehtë
<b>30</b>	<b>20</b>	<b>64</b>

## **INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT**

**IKMT**, Drejtoria Rajonale Fier është një institucion i ri i krijuar në varësi të Ministrisë Brendshme.

**IKMT** Drejtoria Rajonale Fier i ka realizuar objektivat dhe:

ka zbatuar të gjitha urdhërat që kanë ardhur nga **IKMT** qendër,

planet mujore të punës të hartuara bashkërisht me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, bazuar urdhrin të Task- Forcës Vendore,

ka kryer raportimet periodike javore dhe mujore për realizimin e punës së kryer pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe **IKMT** qendër.

Për vitin 2022, ka marrë **9** masa administrative me gjobë të mbajtura me programin unik të inspektimit online.



**Tabela e monitorimeve, kontrolleve dhe inspektimeve të kryera sipas sektorëve, periudha Janar-Dhjetor 2022.**

<b>Fusha Inspektimit/zona /çështja</b>	<b>Mjedisi/Ujëra</b>	<b>Ndërtimi</b>	<b>Pyjet</b>	<b>Totali</b>
Zona me rëndësi kombëtare	43			<b>43</b>
Zona Pyjore			51	<b>51</b>
Zona të tjera (Urbane/ Rurale/Industriale)	51	95		<b>146</b>
Burime Natyrore/ujore	11			<b>11</b>
Shkresa/ankesa/informacion	2	42		<b>44</b>
Masat administrative të mbajtura	9- Masa Adm. Me gjobë.	6- Procesverbale Konstatimi	4- Masa Adm. me gjobë.	<b>295</b>

**Në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë**

Dega e Doganës

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Drejtorinë Rajonale e Formimit Profesional Publik

Drejtorinë Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave

Institutin e Sigurimeve Shoqërore

Drejtoria Rajonale Tatimore

## DEGA E DOGANËS FIER


Objektivi kryesor i degës doganore është mbledhja e të ardhurave doganore si dhe shërbimi sa më profesional i punonjësve ndaj bizneseve dhe individëve.

Analiza e të Ardhurave për periudhën Janar - Dhjetor 2022

### DEGA E DOGANËS FIER

EVIDENCA E TË ARDHURAVE TË REALIZUARA PËR PERIUDHËN 01 JANAR DERI 31 DHJETOR 2022

Nr	Njesite e Qeverisjes Vendore	Te ardhura gjithsej		Te ardhura tatimore		Te ardhura jo tatimore	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Janar	180,000,000	183,832,000	180,000,000	183,832,000	-	294,428
2	Shkurt	260,000,000	269,378,000	260,000,000	269,378,000		219,500
3	Mars	270,000,000	317,851,000	270,000,000	317,851,000		104,355
4	Prill	250,000,000	268,705,000	250,000,000	268,705,000		217,016
5	Maj	250,000,000	280,568,000	250,000,000	280,568,000		334,727
6	Qershor	300,000,000	310,509,000	300,000,000	310,509,000		127,644
7	Korrik	339,799,000	318,672,000	339,799,000	318,672,000		85,000
8	Gusht	350,000,000	312,400,000	350,000,000	312,400,000		250,000
9	Shtator	330,000,000	344,116,000	330,000,000	344,116,000		534,297
10	Tetor	280,000,000	285,714,000	280,000,000	285,714,000		159,753
11	Nentor	300,000,000	330,000,000	300,000,000	330,000,000		289,416
12	Dhjetor	300,000,000	310,403,000	300,000,000	310,403,000		180,000
	<b>SHUMA</b>	<b>3,409,799,000</b>	<b>3,532,148,000</b>	<b>3,409,799,000</b>	<b>3,532,148,000</b>	-	<b>2,796,136</b>



	PLAN
	FAKT

## DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT FIER

Veprimtaria e DRSHKP Fier për vitin 2022 është e përqendruar në rritjen e cilësisë së shërbimeve të punësimit ndaj dy kategorive të klientëve si punëkërkues ashtu edhe punëdhënës si edhe në rritjen e shkallës së bashkëpunimit me institucione dhe organizma të tjerë që kryejnë veprimtarinë e tyre në rrethin Fier dhe kanë si objektiv të tyre uljen e nivelit të papunësisë dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik.


### 1.Situata e papunësisë së regjistruar.

Numri i punëkërkuesve të të papunëve të regjistruar pranë Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit Fier është 6480 pu pa :

Fieri 2776 pupa

Lushnja 2837 pupa

Mallakastër 867 pupa



### Analiza e tregut të punësimit për vitin 2022

#### Realizimi i treguesve të monitorueshëm për vitin 2022:

Janë realizuar 2623 punësime nga 2248 punësime që ishte objektivi ose 116%.

Të ndara sipas kategorive kemi:

1318 pu pa ndërmjetësim

1305 pu pa kanë gjetur vetë punë

#### Analiza e punësimit sipas kategorive të veçanta

Janë punësuar nga ndihma ekonomike 124 punësime të pu.pa nga ndihma, (77 pu pa nga programet e nxitjes +47 punësime )

Janë punësuar 4 pu pa me aftësi të kufizuar ( kjo kategori paraqet vështirësi në punësim thuajse në të gjitha zyrat.

Janë punësuar 26 pu pa nga 71 pu pa që ishte objektivi vjetor ose 36.6 % nga grupet rome & egjiptian. Vështirësia e punësimit të kësaj kategorie është mungesa e arsimit, qëndrueshmëria në punë, refuzimi nga ana e punëdhënësve.

### **Analiza e pupa-ve të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit**

Për vitin 2022 janë përfshirë në projektet e nxitjes së punësimit 250 pu pa nga 199 që ishte objektivi vjetor ose 125.6%.

Me mosrealizim të objektivave është Fieri me 95%, kjo si rezultat i refuzimit të punëkërkuësve të papunë për të marrë pjesë në program. Gjithashtu me mosrealizim është edhe Mallakastër me 82%, rezultat i mungesës së subjekteve dhe studentëve.

### **Analiza e treguesit të vendeve të lira të shpallura për vitin 2022**

Për vitin 2022 janë realizuar 2904 vende të lira pune të shpallura, 121 % të objektivit vjetor.

### **Analiza e treguesit të formimit profesional për vitin 2022**

Për vitin 2022 kanë filluar kurset pranë qendrave të Formimit Profesional 759 pu pa, 81 % të objektivit.

Prej tyre :

10 pu pa PAK

64 pu pa romë

61 pu pa nga NE

Vihet re një mosrealizim nga Sektorët Vendorë Lushnje dhe Mallakastër, kjo si rezultat i largësisë nga DROFPP. Gjithashtu faktorë në mosrealizim është edhe pritja e gjatë në fillimin e kurseve. Është kërkuar nga Drejtoritë e Formimit për të rritur kapacitetet e tyre me qëllim eliminimin e kohës së pritjes së kursantëve të regjistruar në këto kurse.

## DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK FIER

**Misioni i Drejtorisë Rajonale të Ofrit të Formimit Profesional Publik** është materializimi dhe zbatimi në praktikë i politikave të punësimit të Shtetit Shqiptar me qëllim krijimin e kushteve për aftësim profesional veçanërisht të shtresave në nevojë, duke zgjidhur drejtë moton se : "Rruga drejt punësimit kalon nëpërmjet formimit profesional"

Instruktorët të cilat janë rekrutuar kanë arsim të mesëm profesional dhe eksperiencë të profilit teknik dhe didaktik. Për periudhën janar- dhjetor kemi punësuar 17 instruktorë part-time të cilët japin kurse të unifikuara dhe të veçanta.

**Të dhëna statistikore për të certifikuarit për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 janë :**

<b>Të dhënat mbi trajnimin e kurseve</b>	<b>Nr. kursantëve 2021</b>	<b>Nr. kursantëve 2022</b>
<b>Të trajnuar gjithsej gjatë periudhës Janar-Dhjetor</b>	650	908
<b>Nr. i punëkërkuessve të papunë të regjistruar gjatë periudhës Janar-Dhjetor</b>	442	684

**Të dhëna statistikore për të regjistruarit në kurse për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 janë :**

<b>Të dhënat për të regjistruarit</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
<b>Të regjistruar gjithsej gjatë periudhës Janar-Dhjetor</b>	1121	1491
<b>Nr. i punëkërkuessve të papunë të regjistruar gjatë periudhës Janar-Dhjetor</b>	794	1192

Për kategoritë e veçanta pu.pa të ardhura nga zyra e punës për 2022 janë 80 romë/egjiptianë, 21 P.A.K, 75 nga ndihma ekonomike krahasuar me 2021 ku nga këto kategori marrin pjesë 11 romë/egjiptianë, 9 P.A.K, 6 nga ndihma ekonomike.

Në IEVP Fier kanë ndjekur kurset : Saldim, Rrobaqepësi, Kuzhinë me qëllim aftësimin e integritit të kësaj kategorie në tregun e punës 101 kursantë.

Aktualisht nga sistemi i gjurmimit në nivel qendre janë evidentuar 25 kursantë të punësuar dhe vetëpunësuar.

## DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE

### TE ARDHURAT

Të ardhurat kontributive si DRSSH për vitin 2022 u realizuan në masën 112,7 % ose nga 382,000 mijë lekë të planifikuara u realizuan 430,412 mijë lekë, realizuar më shumë 48,412 mijë lekë.

#### Realizimi i të ardhurave kontributive

000/lekë

Totali			Bujku privat			Vullnetari			Të ardhura të tjera		
Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
382,000	430,412	112,7	345,000	388,437	112,6	37,000	41,939	113,3	-	36	

## II. REALIZIMI I BUXHETIT

### a. Rezultati financiar i vitit 2022

000/lekë

Të ardhurat nga bujk+sig vull+tjer	450,039
Shpenz. për Përfitime	14,366,661
Shpenz. Program tjera & sig.suplem.	2,936,544
Shpenzime	219,098
<b>Total</b>	<b>17,522,303</b>
Shpenzime të skemës për tu financuar	17,072,264

### b. Analiza e realizimit të shpenzimeve sipas zërave

Shpenzimet e vitit 2022 në total janë realizuar në masën 103.7%, ose 566 863 mijë lekë më shumë se programi i miratuar në buxhetin e rajonit.

## III. PËRFITIMET AFATGJATA DHE AFATSHKURTRA

### Përfitimet afatgjata

DRSSH Fier menaxhon 85,912 pensione aktive në fund të vitit 2022.

Janë lidhur gjithsej 5,599 pensione të reja gjatë vitit 2022.

-Rritje kanë patur pensionet e pleqërisë, pensionet suplementare si dhe pensionet për shkak të ligjit 29/2019 dt 23.05.2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera nëntoke, të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit dhe punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, në prill 2022 në masën 3.3% sipas VKM nr. 188 datë 30.03.2022, dhe tetor 2022 në masën 6%.

Kështu vlera e një pensioni të plotë minimal duke filluar nga 01.10.2022 është :

Pension shteti = 15,822 mijë lekë

Pension fshati = 10,836 mijë lekë

Pension social = 8,588 mijë lekë

- Me VKM nr.159 datë 13.03.2022 është akorduar **bonusi** për pasojat në rritjen e çmimeve që erdhën prej luftës në Ukrainë **prej 3,000 lekësh** për çdo kategori pensionesh për periudhën **prill-qershor 2022**.

- Gjithashtu në fundvit me VKM nr.753 datë 01.12.2022 është dhënë **bonusi për invalidët në shumën 6,000 lekë**

- Këtë vit **shpërblimet e fundvitit** janë dhënë në masën **5,000 lekë** sipas VKM nr.752 datë 01.12.2022 dhe **8,000 lekë** sipas VKM nr.897 date 29.12.2022, për të gjitha kategoritë e pensioneve.

-Në DRSSH Fier gjatë vitit 2022 janë pritur gjithsej **5,994 kërkesa** për pension pleqërie, familjar, invalid dhe **34 aplikime për pension social**.

**-Pensionet në total (pa skemën suplementare) janë realizuar 99% brenda afatit .**

Kanë qenë arsye objektive që kanë sjellë pensione të caktuara jashtë afatit, këto në një numër më të vogël krahasuar me një vit më parë.

**-Ditët mestare të caktimit të një pensioni në total janë 28 ditë.**

#### **IV. ARKIVA E VJETËRSISË SË PUNËS**

Gjatë vitit 2022 **në total janë përpunuar 15,862 kërkesa**. Nga këto **10,797 kërkesa fizike** i përkasin kërkesave të kryera nga DRSSH Fier dhe DRSSH e tjera, si edhe të ardhura **në rrugë postare**, nga qytetarë të ndryshëm, të ndara si më poshtë: **Ecuria e procesit të dixhitalizimit të shërbimeve publike**. Prej datës 01.05.2022:Me mbylljen e sporteve fizike të agjencive pritëse dhe ADISA\_s, pjesa më e madhe e shërbimeve të DRSSH-së Fier, ofrohen vetëm online përmes portalit e-albania. Kjo gjë solli lehtësira të mëdha, pasi aplikimi për shërbimet e ndryshme mund të bëhet në çdo moment të ditës nga vetë qytetari në çdo cep të botës pa u paraqitur fizikisht.

#### **Realizimi i kërkesave online në DRSSH për Vitin 2022:**

<b>Emërtimi</b>	<b>Nr. aplikimesh</b>
	<b>Viti 2022</b>
<b>Aplikime online në DRSSH</b>	<b>28,369</b>
<b>(pa përfshirë kërkesat për Arkivën e Vjetërsisë së Punës)</b>	

Për t'u ardhur në ndihme qytetarëve për sqarime të ndryshme rreth aplikimeve online dhe shërbimeve në e-albania lidhur me Sigurimet Shoqërore, DRSSH-ja Fier ka vënë në dispozicion edhe 2 numra kontakti. Sot portali e-albania kryen në total 69 shërbime të ndryshme për ISSH-në, nga të cilat në vitin 2022 janë shtuar 2 shërbime te reja :

1. Vërtetim vjetor përfitimi pensioni, me firmë elektronike.
2. Vërtetim negativ përfitimi pensioni , me firmë elektronike.


Për këto vërtetime qytetarit i kthehet përgjigje nëpërmjet portalit në e-albania të llogaria e tij personale, duke mundësuar shkurtimin në kthimin e përgjigjes, pa qenë nevoja e paraqitjes në zyrat e institucionit

## DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, FIER

Misioni i Drejtorisë Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

Në Janar-Dhjetor 2022 janë regjistruar 970 subjekte dhe janë çregjistruar 235 të tillë.

### Të ardhurat



### Arsyetime lidhur me Plan-Fakt-in Janar – Dhjetor 2022

Plani i të ardhurave për periudhën Janar- Dhjetor është realizuar në masën 109% ose 773,010 mijë lekë në neto dhe 102% ose 811,309 mijë lekë në bruto.

Sigurimet janë realizuar 5%, Tvsh bruto 32 % më shumë se plani.

Krahasuar me realizimin e muajit Dhjetor 2021, realizimi neto i muajit Dhjetor 2022 është 28% më shumë ose 171,726 mijë lekë më shumë) dhe realizimi në bruto është 14% ose 93,702 mijë lekë më shumë)

**Me mosrealizim janë: Tatim Fitimi 74% , Tap 87 % , Taksa 93% e planit .**

### DRT Fier realizimi i te ardhurave 12 Mujor 2022


Plani i të ardhurave për 12 mujorin 2022 është realizuar në masën 105% ose (8,728,934 mijë lekë) në neto dhe 103% ose (9,605,895 mijë lekë) në bruto.



Sigurimet janë realizuar 2% më shumë se plani, Tap është realizuar 6 % më shumë se plani, Tvsh 12% më shumë .

Me mosrealizim janë: Tatim Fitimi (89% e planit), taksa nacionale ( 84% e planit).

## Ecuria e shitjeve 2022



## Analiza e Shitjeve pa TVSH, te Përrjashtuara dhe Exportet

Emërtimi i të ardhurave	Janar -Nëntor 22
(9) Shitje të përjashtuara	9,879,431,064
(10) Shitje pa TVSH	1,578,519,802
(11) Eksporte mallrash	12,427,893,273
(12) Furnizime me shkallë 0%	3,319,929,881
<b>Totali</b>	<b>27,205,774,020</b>

## Ne varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Fier.

Autoriteti Rrugor Shqiptar, Gjirokastrë.

OSHEE, Drejtoria Rajonale Fier.

### **DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, FIER**

Shërbimet që janë kryer në DRSHTRR Fier për periudhën Janar –Dhjetor 2022.

Nr.	Shërbimi	Aplikime
		Janar-Dhjetor
1	Regjistrimi i Mjeteve	71352
2	Drejtuesit e mjeteve+ Kualifikime profesionale	67811
3	Taksat	65040
4	Kontrolli teknik + veprime të tjera	76837

### **AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, GJIROKASTËR**

Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë ka në juridiksionin e saj 5 Qarqe të Jugut të Shqipërisë: Qarku Gjirokastrë, Fier, Vlorë, Berat dhe Korçë. Kjo Drejtori ka si aktivitet kryesor ndjekjen, monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve. Në vitin 2022 u lidhën kontrata 4-vjeçare mirëmbajtjeje që menaxhohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Konkretisht për Qarkun e Fierit segmentet rrugore sipas Kontratave janë :

Akset rrugore:

Kufi Rrogozhinë – Fier

Lushnje – Kufi Berat

Këto segmente janë pjesë e Kontratës “C” me Sipërmarrës “2T” shpk,

Akset rrugore :

Fier – Kufi Vlorë

Levan – Kufi Tepelenë

Këto segmente rrugore janë pjesë e Kontratës “D” me sipërmarrës “Salillari”,sh.p.k.

Nga ana e Kompanive sipërmarrëse gjatë vitit 2022 është punuar përgjithësisht mirë në komponentin e mirëmbajtjes rutinë dhe në komponentin e mirëmbajtjes periodike ku janë realizuar punime riparimi të shtresave asfaltike, punime riparimi të veprave të artit dhe punime sinjalistike e sigurie rrugore.

Aktualisht për Qarkun e Fierit akset që janë të mbuluara me kontrata mirëmbajtjeje janë :

Aksi rrugor K/Cermë – Divjakë Plazh

Jeta e Re – Kosovë  
Fier – Seman Plazh + rruga K/Pojan – Apolloni  
K/Patos – Kufi Berat  
K/Patos – Ballsh– Fratar  
Ballsh – Aranitas  
Kr/Rruga Nacionale – Bylis  
Metohasim - Kafaraj

Një problem i madh i këtyre kontratave vazhdon të jetë amortizimi shumë i madh i një pjese të akseve rrugore. Më problematik paraqitet aksi rrugor K/Patos – Ballsh – Fratar 41.1 km.

Në lidhje me projektet në rrugët në inventar të Autoritetit Rrugor Shqiptar janë realizuar disa objekte nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit sic janë :

Rikonstruksion rruga K/Cermë – Divjakë.  
Rikonstruksion rruga Roskovec – Poshnje.  
Rikonstruksion rruga Topojë – Grykë.

**Misioni: Përbushja e kërkesave të konsumatorëve për furnizim të pandërprerë dhe cilësor me energji elektrike nëpërmjet një shërbimi efikas dhe modern.**

Ushtron aktivitetin e saj në Rajonin Jug-Perëndim, me varësi direkte nga Drejtoria e Tensionit të Lartë Tiranë/ Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) .Mbulon me aktivitetin e saj n/st dhe linja 35kV në prefekturat Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier. Në Fier përkatësisht me bashkitë: Fier, Roskovec, Patos, Mallakastër, Lushnjë dhe Divjakë

**Objektivi:** Qëllimi dhe detyra e OSSH është të sigurojë furnizimin me energji elektrike me cilësi dhe pa ndërprerje tek konsumatorët.

Puna OSSH konsiston në :

Ndjekje dhe raportim defektesh

Parandalimin dhe eliminimin e avarive në N/st dhe linjat 35 kV

Bashkërendim të punës me operatorët e N/st për të pasur një rendiment sa më të lartë në shfrytëzimin e pajisjeve dhe eliminimin e avarive .

Realizimin e humbjeve të energjisë elektrike brenda kufijve të caktuar

Realizimin me cilësi të remonteve sipas grafikut të miratuar për pajisjet e N/st dhe linjave

Zbatimit me korrektësi të rregullores së sigurimit teknik gjatë punimeve .

Gjatë vitit 2022 janë kryer 58 remonte në linja nga 60 të planifikuara, realizimi në % është 96 %.

Gjatë vitit 2022 janë kryer 159 remonte në n/st nga 162 të planifikuara, realizimi në % është 98 %.

Gjatë vitit 2022 si rezultat i kushteve të motit dhe amortizimit të pajisjeve kanë patur 75 avari, 24 defekte në linja dhe 51 defekte në n/st. Në të gjitha rastet e ndodhjes së avarive brigadat e eliminimit të tyre kanë qenë në gatishmëri të plotë duke bërë të mundur lokalizimin, izolimin dhe eliminimin e avarive në një kohë shumë të shkurtër .

Në të gjitha rastet e ndodhjes së avarive brigadat e eliminimit të tyre kanë qenë në gatishmëri të plotë.

Disa nga problematikat që çojnë në kohëzgjatje të defekteve janë:

gjendja teknike e makinave,

terreni dhe koha e papërshtatshme për ndërhyrjet,

lloji i defektit (tokë, izolator i shpuar)

probleme me çelësat e vjetër që kanë bllokime mekanike apo operatorë që nuk mësojnë dhe që nuk bëjnë detyrën.

Gjatë vitit 2022 janë kryer investime në n/st dhe në linja me qëllim përmirësimin e gjendjes në to, rritjen e shkallës së sigurisë dhe garantimin e furnizimit me energji pa ndërprerje. Njëkohësisht janë kryer investime në pajisjet primare të disa n/st.

Falë këtyre investimeve dhe remonteve cilësore të kryera nga grupet e mirëmbajtjes është bërë e mundur që të përballohen me sukses nevojat për energji të konsumatorëve dhe njëkohësisht të ulët ndjeshëm numri i stakimeve.

**Humbjet:** Humbjet në % në vitin 2021 :

Plani **2.547**

Realizimi **1.41**

**Siguria në punë :** Gjatë vitit 2022 nuk ka patur aksidente në punë të punonjësve as përmbajtje e as dëgjie të N/st.

Problematikat e sigurimit teknik :

Sasia e mjeteve mbrojtëse është më e vogël se ajo e kërkuar nga Rregullorja e Sigurimit Teknik dhe Shfrytëzimit të Impianteve Elektrike.

Testimi i mjeteve mbrojtëse

Këndi MNZ

**Logjistika, Problematikat:**

Problematikë mbetet fakti që automjetet, krahas riparimeve që u bëhen në servis, vazhdojnë të shfaqin po përsëri defekte për shkak edhe të amortizimit të tyre gjë e cila sjell vonesa edhe në kryerjen e punëve të Njesisë.

Furnizimi me karburant bëhet në fillim të cdo muaji, por sasia jo gjithmonë është e mjaftueshme. Kjo gjë pengon punën e brigadave në rast avarie ose remonti.

Problematikë tjetër mbetet edhe mungesa e furnizimit me ujë të n/st të NJTL Jug- Perëndim.

**Problematikat e Burimeve Njerëzore:**

Njësia TL Jug -Perëndim Fier ka në përbërje të saj 255 punonjës dhe administron 55 n/st në shtrirje gjeografike Jug-Perëndim. Problematika kryesore e burimeve njerëzore është mungesa e personelit si atij operativ edhe atij inxhinierik.

Problem është edhe niveli i ulët i pagave të Inxhinierëve dhe shefave të degëve .

## **Në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

Drejtoria Rajonale Arsimore, Fier

### **DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER**

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Fier ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit Parauniversitar në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit Parauniversitar me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrën që të përballojë sfidat e së ardhmes.

DRAP, Fier ka në varësi të saj :

**ZVA, FIER**

**ZVA, DIVJAKË**

**ZVA, LUSHNJE**

**ZVA, PATOS**

**ZVA , MALLAKASTËR**

**ZVA, ROSKOVEC**

Gjatë vitit 2022 DRAP Fier ka realizuar :

Rritjen e nivelit të drejtimit të institucioneve arsimore dhe fuqizimin e burimeve njerëzore në institucionet e vartësisë.

Mbështetjen fuqimisht të DPAP dhe ASCAP për zbatimin e strategjive dhe politikave reformuese në sistemin e arsimit Parauniversitar.

Realizimin e zhvillimit profesional të mësuesve nëpërmjet bashkëpunimit mes tyre dhe aktorëve të specializuar.

Inspektimin e procesit të punësimit të mësuesve sipas portalit, në bashkëpunim me sektorin e inspektimit dhe kurrikulës dhe me DPAP.

Ndjekjen e procedurave për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të IA, është ndjekur procedura 100%, por për shkak të mosplotësisë të kriterëve nga kandidatët nuk është finalizuar emërimi i të gjithë drejtuesve.

Verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë.

Verifikimin e regjistrimeve të nxënësve në ZVAP dhe institucionet arsimore para universitare publike dhe private.

*Është monitoruar procesi i regjistrimit të nxënësve të rinj nëpërmjet portalit e-Albania dhe sistemit të menaxhimit të informacionit Parauniversitar (SMIP). Në këtë proces DRAP ka përpunuar informacionin drejtpërdrejt nga ZVAP e vartësisë, por nuk ka pasur akses në SMIP për monitorimin e plotë të ecurisë së programit.*

Ndjekjen e zbatimit të kurrikulës së re.

Monitorimin e procesit të shpërndarjes së teksteve shkollore në ZVAP-të dhe institucionet arsimore publike.

Monitorimin e procesit të provimeve kombëtare në arsimin bazë dhe në Maturën Shtetërore sesioni i parë dhe i dytë dhe vlerësimin e arritjeve në arsimin fillor.

Vlerësimin e procesit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Vlerësimin e procedurave të Kartës së Performancës së shkollave në ZVAP-të e vartësisë.

*DRAP ka grumbulluar tabelat e renditjes së kartës së performancës së shkollave për të gjitha ZVAP-et e vartësisë, të hartuara sipas udhëzuesit të ri për vitin shkollor 2021-2022*

*Analizimin e gjetjeve nga inspektimet dhe monitorimet, të cilat do të shoqërohen me rekomandime për përmirësim të punës në institucionet arsimore*

*Gjatë muajit shtator, tetor, nëntor, dhjetor sektori i kurrikulës ka marrë pjesë në inspektime të plota të organizuara nga DPAP dhe ASCAP në 4 DRAP-et.*

Trajtimin e ankesave të mundshme dhe çështjet e dërguara nga Portali i Bashkëqeverisjes.

Zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për mallrat dhe shërbimet në funksion të përmirësimit të sistemit arsimor.

### **Në varësi të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe administrimit të Ujërave**

Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Lushnjë

Spektori i Bordit të Kullimit

Autoritetin Kombëtar i Ushqimit

## **AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR LUSHNJË**

### **Për vitin 2022 AREB, Lushnje ka patur objektivat si më poshtë:**

Krijimi i lidhjeve dhe vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me aktorët e ndryshëm që veprojnë në bujqësi për të siguruar informacion të ndërsjellët.

Organizimi i takimeve, kontakteve me partnerët e identifikuar, krijimi i lidhjeve dhe rrjetit të bashkëpunimit.

Sigurimi, menaxhimi dhe publikimi informacionit tekniko–shkencor, ekonomik dhe tregut.

Update dhe plotësimi i regjistrit të fermës.

Menaxhimi i fermës .

Rritja e efektivitetit në realizimin e skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë

Rritja e prodhimit të ullirit.

Rritja e efektivitetit të skemave mbështetëse në bujqësi.

Rritja e prodhimit në pemët frutore .

Rritja e prodhimit në vreshta .

Rritja e prodhimit në kulturën e grurit.

Rritja e prodhimit në kulturat perimore.

Rritja dhe intensifikimi i prodhimit foragjer.

Nxitja dhe mbështetja e iniciativave të fermerëve për kooperim, në shoqata dhe SHBB

Bujqësia biologjike një alternative reale e prodhimit bujqësor .

Rritja e rolit të gruas në menaxhimin e fermës.

### **Realizimi i objektivave për periudhën Janar – Dhjetor 2022 në SEB – Fier.**

**Në drejtim të zbatimit të programeve (objektivave) të ekstensionit** dhe aktiviteteve të planifikuara janë realizuar **16** programe të ekstensionit me **24** aktivitetet përkatëse. Nga ekstensionistët e SEB Fier në

funksion të realizimit të Planit Vjetor të Ekstensionit janë zhvilluar 359 takime në grupe dhe demonstrime praktike me fermerë që kanë pasur si objektiva për, *Njohja dhe informimi i fermerëve për masat e financimit, kriteret për aplikim në skemat mbështetëse kombëtare që do të zbatohen gjatë vitit 2022, asistimi i tyre për përgatitjen e projekteve dhe dokumentacionit, Shërbimet gjithëvjeto në ulla dhe faktor të rëndësishëm në zbutjen e periodicitetit në prodhimin e ulliri, njohuri për sistemin e plehërimit në pemët frutore, shërbimet kryesore në vreshta ( plehërimet, krasitjet, spërkatjet. etj.), hallkat më të rëndësishme të teknologjisë së mbjelljes dhe kultivimit të grurit, Njohuri për kultivarët e rinj, përshtatja e teknologjisë për prodhimin e perimeve, Përmirësimi i strukturës së mbjelljeve të kulturave foragjere në fermë, Hallkat më të rëndësishme të teknologjisë së kultivimit të misrit për kokërr e silazh, Njohuri për menaxhimin e qumështit brenda kushteve higjieno-sanitare, Nxitja e iniciativës së fermerëve dhe grupeve të fermerëve për kooperim dhe bashkëpunim midis tyre, në nivel grupi, fshati apo komunë në shoqata dhe SHBB, Njohja me ligjin ri, dokumentacionin përkatës mbështetur në standardet në fermat BIO, Roli i gruas në përgatitjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në kushtet e fermës 3450 fermerë të kontaktit në rrethet Fier, Lushnje dhe Mallakastër.*

Janë realizuar 525 vizita në fermë për të vrojtuar planifikimin në fermë, diagnostikimi i saj me ndihmën e të ardhurave bruto, ku të qartësohet efekti i përfitimit nga përdorimi me efikasitet i faktorëve të tillë si baza materiale, aplikimi i teknologjive, shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve prodhuese të tokës e blegtorisë, ndryshime në strukturën e mbjelljeve dhe kafshëve që mbarështon, përfshirja në procesin e marketingut, etj.

Për ofrimin e informacionit dhe këshillimit për zhvillimin teknik dhe teknologjik të fermave bujqësore me qëllim rritjen e konkurrencës në treg, për furnizimin me inpute, tregun, kredi, kooperimin, etj., në 7-të qendrat e informacionit bujqësor në Qarkun e Fierit janë pritur 3918 vizitorë.

Ekstensionistët kanë kryer në terren 5826 takime individuale me fermerë dhe 428 takime me tregtarë inputesh, grumbullues e përpunuesit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, projekte, organizata e fondacione me aktivitet në qarkun e Fierit, banka private, etj., dhe me strukturat drejtuese të shoqatave, grupeve të fermerëve, SH.B.B.-ve për të mbështetur dhe ndihmuar në procesin e ngritjes, konsolidimit dhe funksionimit të tyre dhe kanë shpërndarë për fermerët 3 tituj të ri fletëpalosje me 836 copë dhe 36 tituj të riprodhuar fletëpalosje me 919 copë.

Për përdorimin me efektivitet të medias në pasqyrimin e aktiviteteve të ekstensionit dhe përhapjen e mesazheve të ekstensionit të fermerët janë dhënë në median TV lokale 29 informacione për problematikën e kohës dhe mesazhe të ekstensionit.

Janë zhvilluar nga specialistët e ekstensionit gjithsej 276 tema të trajnimit me fermerë me 2685 pjesëmarrës, në 352 fshatra me problematikë për shërbimet dhe trajtimet dimërore në pemët frutore, vreshta dhe ullinj, teknologjinë për mbjelljen e serave dhe drufrutorëve të rinj, higjienën dhe profilaksinë në stalla për gjedhin, për shërbimet në perimet e serave, teknologjinë e mbjelljes dhe kultivimit të jonxhës së re, shërbimet në grurë, bujqësinë organike, të ushqyerit e viçave, për



teknologjitë e mbjelljes së lulediellit, misrit, fasules, sojës, për plehërimin dhe kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në perimet e serave, kontrollin e syrit të palloit dhe tenjës së ullirit, krasitjet e gjelbërta në vreshta, trajtimet kimike në vreshta, teknologjia e mbjelljes së bostanoreve në tunele, shërbimet në misër, njohja e hibrideve të rinj të misrit, prodhimin e farës së jonxhës, teknologji të kultivimit të perimeve të dyta, masat përgatitore për mbjelljen e grurit, shërbimet në kulturat foragjere, koha dhe teknikat e vjeljes së ullirit, teknologjia e kultivimit të grurit, mbarështimi i të imtave, plehërimi i ullirit, përdorimi i mikroplehrave në sera, mbajtja e buxhetit të fermës, për teknologjinë e mbjelljes dhe kultivimit të grurit, qarkullimet bujqësore në fermë, bujqësinë organike, përpunimin e plehut organik në fermë, shërbimet në vreshta, pemë frutore e ullinj, kooperimin dhe organizimin e SHBB-ve, teknikat e vjeljes dhe përpunimit të ullirit, mbjelljet e reja në drufrutorë, të ushqyerit, shërbimet dhe kujdesi për bagëtinë gjatë dimrit, kooperimin dhe organizimin e SHBB-ve, teknologjinë e mbjelljes dhe kultivimit të foragjereve, për mbarështimin e gjelit të detit, informimi i fermerëve dhe rëndësia për skemat kombëtare dhe skema e naftës etj.

Për buxhetet e fermave u ndoqën në nivel qarku 42 buxhete në ferma me drejtimeve të ndryshme në bujqësi e blegtori për mbajtjen e shënimeve për buxhetin e fermës me aktivitet në perime, ullinj, pemëtari, vreshtari, bimët e arave, gjedhë, të imta, shpendë, etj. Gjatë të gjithë vitit janë asistuar fermerët e listuar për mbajtjen e llogarisë së fermës.

- ◆ Evidentimi i 3338 fermerëve intensiv, nga të cilët në Fier 2048, Lushnje 995, dhe Mallakastër 295, sipas kritereve të përcaktuar në bujqësi dhe blegtori, në nivel fshati, njësie administrative dhe rrethi.
- ◆ Gjatë muajit shkurt u realizua evidentimi i aktivitetit të 60 pikave të grumbullimit të frutave dhe perimeve në qarkun e Fierit për kapacitetet magazinuese, frigoriferike, eksportet, tregjet dhe numrin e fermerëve që bashkëpunojnë gjatë vitit 2022.
- ◆ Gjatë muajve janar-shkurt 2022 u krye mbledhja e të dhënave statistikore dhe hedhja në data bazë për treguesit në nivel ferme të prodhimit bujqësor e blegtoral, të shpenzimeve, të shitjeve, të të ardhurave, investimeve, etj., për 2598 ferma të përzgjedhura nga MBZHR në qarkun e Fierit për Vrojtimin Vjetor Bujqësor të vitit 2021.
- ◆ Në kuadrin e evidentimit të subjekteve agropërpunuese me aktivitet në Qarkun e Fierit u krye listimi i 287 subjekteve agropërpunuese, nga të cilat 169 në rrethin e Fierit, 98 në rrethin e Lushnjës dhe 20 në rrethin e Mallakastrës. Janë listuar të gjitha subjekte agropërpunuese me aktivitet në përpunimin e ullirit për vaj, të perimeve dhe frutave, sallameri, mulli bloje e furra buke, prodhim të ëmbëlsirave, stabilimente e baxho për përpunimin e qumështit, prodhim vere, të pijeve jo alkoolike, etj. dhe në muajin Qershor 2022 u realizua vrojtimi i 65 subjekteve të përzgjedhur nga lista në qarkun e Fierit.

◆ Përfundoi hedhja në database me informacionin e grumbulluar nga intervistimet e kryera për Vrojtimin Pilot të Sipërfaqes së Mbjellë për 2447 fermat e përzgjedhura në Qarkun e Fierit për vitin 2022.

◆ Në kuadrin e përgatitje të “Regjistrit të serave” nëpërmjet listimit të të gjithë fermerëve të qarkut Fier që kultivojnë kulturat bujqësore në ambiente të mbrojtura, u evidentuan rreth 4725 fermerë për sipërfaqet në sera, kulturat e mbjella ( perime, luleshtrydhe, agrume, vreshta, etj.), konstruksionin dhe tipin e serës, sistemin e ngrohjes, etj. Kjo detyrë e dhënë nga MBZHR përfundoj brenda muajit prill 2022.

◆ Ndërkohë për tu ardhur në ndihmë tregtarëve të pikave të grumbullimit dhe të tregtarëve me shumicë dhe pakicë të prodhimeve bujqësore e blegtorale si dhe shoqatave të fermerëve, SHBB-ve, grupeve prodhuese dhe fermerëve potencialë për tregtimin e prodhimeve të tyre përfundoi plotësimi i pasqyrave të parashikimit të potencialeve prodhuese të kulturave bujqësore ( fruta, perime, patate, etj. ) dhe blegtorale ( mish, qumësht, mjaltë, etj. ) për treg të brendshëm dhe eksport për vitin 2022 dhe krijimi i një hartë të potencialeve prodhuese për tregun e brendshëm dhe për eksport të 3025 prodhuesve në qarkun e Fierit dhe të grafikëve konvejer për periudhën e daljes së këtyre prodhime bujqësore e blegtorale në treg.

◆ U realizua nga specialistët e ekstensionit mbledhja e të dhënave statistikore për parashikim e I-rë dhe të II-të të prodhimit bujqësor dhe blegtoral në nivel bashkie, rrethi dhe qarkut Fier për vitin 2022.

◆ Në zbatim të Udhëzimit të MBZHR nr.14, datë 20.10.2020, “ Për kushtet dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të fermës” gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 është punuar në drejtim të plotësimit të Regjistrit Kombëtar të Fermës me të dhëna për identitetin e fermerit, pronësinë e tokës bujqësore, llojin dhe numrin e kafshëve bujqësore, mekanikën bujqësore, përfitimet nga skemat etj., për 15000 ferma në Qarkun e Fierit.

◆ Në muajin dhjetor 2022 u mblodhën të dhënat statistikore, u përpunuan u hodhën në program dhe u raportuan në MBZHR për Raportin Vjetor Statistikor Bujqësor dhe Raporti Teknik i Blegtorisë për vitin 2022 në Qarkun e Fierit.

◆ Ka vazhduar puna për formalizimin e fermerëve dhe plotësimin e dokumentacionit për pajisjen e tyre me NIPT fermeri. Deri në fund të vitit 2022 në nivel Qarku kanë aplikuar në DPTT Fier për tu pajisur me NIPT fermeri 29948 fermerë dhe gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 kanë aplikuar 7967 fermerë. Rritja e numrit të aplikantëve për tu pajisur me NIPT fermeri gjatë muajve shkurt, mars ka ardhur si nevojë për të aplikuar në skemën e furnizimit me karburant për bujqësinë që u zbatua gjatë vitit 2022.

◆ Janë kryer me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier 30 ekspertiza vlerësimi të dëmit ekonomik për dëmtime në ullinj, pemë frutore, vreshta, bimë të arave, blegtori. etj.

◆ Në zbatim të Planit të Masave të Veprimit kundër kultivimit të kanabisit për vitin 2022 me detyra të programuara në drejtim të ndërgjegjësimit të fermerëve për mos mbjelljen e bimëve narkotike në aktivitetet e ekstensionit të planifikuara dhe të zhvilluara gjatë këtij viti, si takimet në grupe, demonstrimet fushore, trajnimet me fermerë, takimet individuale, veçanërisht takimet në kuadrin

e promovimit të skemave mbështetëse në bujqësi të vitit 2022 krahas problematikës së planifikuar për tu trajtuar me fermerët është folur edhe kundër kultivimit të kanabisit, pasojave, ndërgjegjësimit për dëmet dhe janë orientuar drejt kultivimit të kulturave bujqësore sipas rajonizimit dhe aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale fitimprurëse.

◆ Ndër angazhimet më të rëndësishme të stafit të Sektorit të Ekstensionit Bujqësor Fier gjatë vitit 2022 ka qenë zbatimi i detyrës dhe përgjegjësisë për të ofruar informacion dhe të asistencë fermerëve për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, skema e përfitimit me naftë për bujqësinë, IPARD-it dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në zbatim të kësaj detyre dhe të politikave të Qeverisë për të vazhduar mbështetjen e prodhimit bujqësor me pagesa direkte nëpërmjet aplikimit të skemave mbështetëse kombëtare të bazuar në prioritetet e përcaktuara në rajonizimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, të Programit IPARD II dhe të projekteve të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural puna e Sektorit të Ekstensionit Bujqësor Fier për realizimin e skemave mbështetëse në bujqësi dhe përfitimit me naftë për vitin 2022 ka qenë shumë efektive.

Në zbatim të VKM dhe Udhëzimit të MBZHR dhe MF **për skemat mbështetëse kombëtare** të vitit 2022 për gjatë muajit janar, shkurt, mars është punuar në drejtim të informimit të fermerëve dhe subjekteve të interesuara për skemat kombëtare që do të financohen për vitin 2022. Në disa Njësi Administrative në bashkëpunim me AZHBR janë zhvilluar takime promovuese me pjesëmarrjen e fermerëve dhe specialistëve të ekstensionit për hapjen e fushatës për informimin e fermerëve për SMK në qarkun e Fierit. Janë asistuar fermerët për të aplikuar online në SKM nga grupet e ekstensionistëve të ngritura në ndihmesë të fermerëve aplikues.

Në skemat kombëtare të vitit 2022 kanë aplikuar në qarkun e Fierit 17048 fermerë, nga të cilët:

MASA	APLIKUES	PERFITUES
- në masën e tufës bazë ( dele/dhi/lopë )	793	502
- mbarështimi bletarisë	261	232
- Fara, fidanë dhe inpute;	413	188
- fermtat organike	58	12
- certifikimi Global GAP	2	0
- bime medicinale	27	2
- mbjellje gruri	1449	661
- nafta për bujqësinë	14045	10315

Në masën shtesë për mbjellje gruri nga 1191 aplikues kanë plotësuar kriteret e përfitimit 661 aplikues me sipërfaqe 3768 ha, për të cilët është bërë kalimi i përfitimit dhe jemi në proces përfundimi deri në këtë moment për arsye të festave të fundvitit.

Për përfitimin e karburantit për bujqësinë nga 14045 aplikues përfituan 10200 aplikues brenda vijës së financimit.

Në zbatim të VKM dhe Udhëzimit të MBZHR dhe MF për skemat mbështetëse kombëtare të vitit 2022 gjatë muajve prill - dhjetor është punuar në drejtim të njoftimit, ndjekjes, konsultimit asistimit, kontrollit L." 11 Janari ", Rr. "Ramis Aranitasi" Fier, Tel. 034 607 080, <http://prefektifier.gov.aal>; [prefekti.fier@mb.gov.al](mailto:prefekti.fier@mb.gov.al)

të dosjeve dhe përgatitjes së projekte për të gjithë aplikantët që janë renditur mbi vijat e financimit në secilën masë të skemave mbështetëse kombëtare të vitit 2022, të cilëve ju është pranuar dokumentacioni në Agropikat Fier dhe Lushnje.

Krahas arritjeve gjatë vitit 2022 janë evidentuar edhe mangësi, të meta, rezerva e mundësi për të korrigjuar e përmirësuar punën për të ardhmen, veçanërisht në organizimin me nivel më cilësor dhe me pjesëmarrje të aktiviteteve të planifikuara të ekstensionit ( takimet në grupe, demonstrimet, vizitat në fermë, trajnimeve me fermerë, etj.), nivel më të lartë të informacionit teknik e teknologjik për fermerët, trajnimit profesional sepse një pjesë e stafit janë të rinj dhe pa eksperiencë, në nxitjen e fermerëve për kooperim në shoqata e SHBB, njohjen e aktivitetit të pikave të grumbullimit, agropërpunuesve, agrotregtarëve dhe tregjeve, njohjen, prezantimin dhe përgjithësimin e përvojës së fermave të përparuara të fermerëve intensiv e potencial, përmirësimin e menaxhimit dhe të treguesve ekonomik e financiar të fermave, në funksionimin më të mirë të qendrave të informacionit bujqësor, ku kërkohet një nivel më i lartë në drejtim të dhënies së informacionit dhe shtimit të gamës së tij, në drejtim të promovimit, të njohjes të aktivitetit dhe për ngritjen e qendrave të reja të informacionit në qarkun e Fierit.

**Ndër faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa nga objektivat dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2022 do të veçonim:**

Angazhimi i disa prej specialistëve të terrenit në kontrollin administrativ të skemës së furnizimit me naftë për bujqësinë.

Disa aktivitete të ekstensionit në grupe ( takime në grupe, demonstrime, trajnime të hapura me fermerë dhe specialistë, etj.) nuk janë zhvilluar për shkak të gjendjes shëndetësore të një specialisti zone.

Mos plotësimi i organikës së planifikuar në strukturën e SEB Fier , ku nga 26 specialistë të planifikuar janë aktualisht 21 specialistë, kemi vende vakante 5 ekstensionistë terreni, duke sjellë për pasojë ngarkesë për disa zona dhe mosmbulim të gjitha zonave të qarkut me aktivitete të ekstensionit.

## SEKTORI I BORDIT TË KULLIMIT

Realizimi i punimeve për mirëmbajtje për vitin 2021 është si më poshtë:

Objekte te mirembajtjes ne ujitte	Vlera per vitin 2022	Bashkia perfituese	Tregues te projektit			Realizimi	
			m <sup>3</sup> dhera te larguar	km te pastruar/ mirembajtur	ha qe i permiresohet ujtja nga mirembajtja	m <sup>3</sup> dhera	Km
<b>Total ujitje &amp; Kullim</b>	<b>2,765,654</b>		<b>112,001</b>	<b>113</b>	<b>81,750</b>		
<b>Total ujitje</b>	<b>2,765,654</b>		<b>36,000</b>	<b>37.8</b>	<b>27,250</b>	<b>63000</b>	<b>28</b>
<b>Sektori Lushnje</b>	<b>1,310,054</b>		<b>18,000</b>	<b>17</b>	<b>6,450</b>	<b>18000</b>	<b>12</b>
Dega e Lushnjes	749,634	Lushnje	10,300.0	5.8	3,800.0	10300	6
V-1 Dega Terbuf	560,420	Lushnje & Divjake	7,700	11	2,650	7700	6
<b>Sektori Fier</b>	<b>1,455,600</b>		<b>20,000</b>	<b>21.0</b>	<b>20,800</b>	<b>45000</b>	<b>16</b>
Vepra e marjjes ne Selishte	1,310,040	Fier	18,000	1	16,000	30000	1
Sistemi Kurjan-Strum	145,560	Roskovec & Patos & Fier	2,000	20.0	4,800	15000	15
<b>Objekte te mirembajtjes ne kullim (kanale kullues, kanale te ujerave te larta dhe argjinatura etj)</b>	<b>Vlera per vitin 2022</b>	<b>Bashkia</b>	<b>m<sup>3</sup> dhera te larguar</b>	<b>km te pastruar/ sistemuar</b>	<b>ha qe i permiresohen treguesit e kullimit</b>		
<b>Totali Kullim</b>	<b>32,659,180</b>		<b>426,000</b>	<b>37</b>	<b>25,200</b>	<b>310393</b>	<b>19.79</b>
<b>Sektori Lushnje</b>	<b>13,451,680</b>		<b>176,000</b>	<b>27.10</b>	<b>14,700</b>	<b>80403</b>	<b>8.35</b>
KUL Grabian-Gradishte	4,700,445	Divjake	61,500	6.4	2,300		
KUL Golem	1,872,535	Lushnje	24,500	3.00	1,200	24500	2.3
Perroi i Lushnjes	1,375,740	Lushnje	18,000	2.00	2,500	29903	2.05
LUK 3-4-0	1,987,180	Divjake	26,000	6.20	1,300	21916	3.2
LUK 3-4	1,987,180		26,000	4.50	2,000	26000	4
Mbing. argji. Emisarit te Myzeqese	1,528,600	Divjake	20,000	5.00	5,400	19995	3
<b>Sektori Fier</b>	<b>19,207,500</b>		<b>250,000</b>	<b>10.00</b>	<b>10,500</b>	<b>229990</b>	<b>11.44</b>
Kolektori Roskovec-Hoxhare (K-R-H)	13,061,100	Roskovec-Patos-Fier	170,000	5.00	6,000	147000	5.14
KUL Levan-Pojan	6,146,400	Fier	80,000	5.00	4,500	70000	3
Shtراطي perbashket Hekal-Mollaj						2990	1.3
Nderhyrje ne Kolektorin e Shushecit,Fr						10000	2

## AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT, FIER

Misioni kryesor i AKU-së është garantimi i shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtja e konsumatorit.

Të vendosë dhe të konsolidojë në vijimësi bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesat e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar dhe në të gjitha fazat e trajtimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë.

Gjatë Vitit 2022 DRAKU Fier ka kryer 1914 inspektime si më poshtë:

965 inspektime të kryera nga sektori OSH (Sektori i ushqimit me origjinë shtazore)

949 inspektime të kryera nga sektori OJSH (Sektori i ushqimit me origjinë joshstazore)

Nga këto 1675 inspektime janë kryer në zbatim të planit vjetor 2022 të inspektimeve, dhe 239 inspektime jashtë planit si:

Kërkesa të subjektit

Denoncime nga infoaku

L. "11 Janari", Rr. "Ramis Aranitasi" Fier, Tel. 034 607 080, <http://prefektifier.gov.al>; [prefekti.fier@mb.gov.al](mailto:prefekti.fier@mb.gov.al)

Bashkëpunime ndërinstitucionale me AKVMB-në dhe krimin ekonomik

Njoftim nga DP

Procedurë marrje mostre

Njoftim nga RASFF

Ri inspektime

Kërkesa për licenca

Kërkesa për miratim nipti

Kërkesa për leje higjeno-sanitare

DRAKU Fier ka kryer 158 inspektime në PIK

142 inspektime me origjinë jo shtazore

16 inspektime me origjinë shtazore

**Nga inspektimet e kryera janë konstatuar problematikat e mëposhtme:**

- Nuk janë rinovuar librezat shëndetësore të personelit.
  - Nuk është rinovuar analiza e ujit.
  - Nuk është rinovuar plani DDD.
  - Lyerje pjesë tavani të pa pastra .
  - Ambienti i prodhimit ka nevojë për lyerje.
  - Të zëvendësohen kapakët e dëmtuar të kontejnerëve të mbetjeve
  - Konstatim i sendeve të tepërta në ambientet e prodhimit e tregtimit.
  - Nuk ka ndarje korrekte të produkteve në frigoriferë sipas llojit dhe ruajtjes.
- Për të cilat janë vendosur : 696 masa administrative "Paralajmërim"

45 masa administrative "Gjobë" në vlerën 5680 000 lekë për arsye:

Nga inspektimi në terren :

- 598 subjekte janë konstatuar të mbyllura në momentin e inspektimit
- 63 subjekte janë konstatuar çregjistruar/pezulluar nga verifikimi në QKB
- 9 Subjekte u konstatuan jashtë fushës së sigurisë ushqimore

**Në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale :**

Drejtoria e Spitalit Rajonal

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror

## DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL, FIER

Në total për 2022 janë kryer 130 452 vizita.

### Urgjenca 2021-2022

Urgjenca	2021	2022
Pacientë që trajtohen në urgjencë	70,317	82,054
Transferimet e Urgjencës	979	700

Spitali Rajonal Fier ka realizuar të Ardhurat dytësore për realizimin e rikonstruksionit të godinës së maternitetit si dhe ka përgatitur projektin .

## NJËSITË VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në Qarkun Fier operojnë Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor :

NJVKSH, Fier

NJVKSH, Lushnje

NJVKSH, Mallakastër

### **NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR FIER**

Janë 7558 testime më pak në krahasim me vitin 2021 përgjatë të cilit u kryen **26860** testime ose mesatarisht 75 testime (RT + PCR) në ditë;

Teste RT janë realizuar **15857 testime**/mesatarisht 43.5 në ditë (përbëjnë 82 % të numrit total të testimeve) ku në krahasim me vitin 2021 përgjatë të cilit u kryen **18278 testime**/mesatarisht 51 në ditë ( përbëjnë 68 % të numrit total të testimeve). Pra në vitin 2022 janë kryer 2421 testime RT më pak (megjithëse ka pasur më shumë pika testuese në krahasim me 2021) dhe është rritur përqindja e testeve të shpejta në raport me testet RT- PCR (në 2021 RT përbënin 68 % të të gjithë testeve, ndërsa në 2022 përbënin 82%).

Teste **PCR janë realizuar 3445 teste**/mesatarisht 9.5 teste në ditë ndërsa në vitin 2021 janë realizuar **8582 teste**/mesatarisht 24 teste në ditë. Pra në vitin 2022, në raport me vitin 2021, ka pasur një ulje të ndjeshme të testimit me RT-PCR (5137 testime më pak) për arsye kryesisht logjistike që ka të bëjë me problematikat e transportit të mostrave në pikën e vetme analizuese, ISHP.

Pozitiviteti i RT-PCR për vitin 2022 është **43 %** që është më i lartë nëse e krahasojmë me vitin 2021, ku Pozitiviteti i RT-PCR ka qenë **26 %**.

Muaji me pozitivitetin më të lartë është muaji *gusht* (70.7 %), ndërsa në vitin 2021 ka qenë *muaji shkurt* (47 %).

Muajt me pozitivitetin më të ulët janë muajt tetor dhe nëntor (12.5% dhe 12.7%), ndërsa në vitin 2021 muajt me pozitivitetin më të ulët kanë qenë muajt qershor dhe korrik (përkatësisht me pozitivitet 0 % dhe 2 %);

Pozitiviteti në total i RT-PCR + RT për vitin 2022 është **37 %** (ndërsa në vitin 2021 pozitiviteti ka qenë 29 %).

Muaji me pozitivitetin më të lartë është **muaji korrik (57%) dhe gusht (56%)** ku nëse e krahasojmë me vitin 2021 muaji me pozitivitetin më të lartë ka qenë muaji shkurt (63 %).

Muaji me pozitivitetin më të ulët në vitin 2022 është muaji tetor dhe nëntor (përkatësisht me pozitivitet 8 % dhe 9 %) dhe nëse e krahasojmë me vitin 2021 muaji me pozitivitetin më të ulët ka qenë muaji qershor dhe korrik (1% dhe 3%);

Pozitiviteti i RT për vitin 2022 është **36 %** (në të njëjtën vlerë ka qenë edhe në vitin 2021) ku muaji me pozitivitetin më të ulët është muaji tetor dhe nëntor (përkatësisht me pozitivitet 7 % dhe 8 %) dhe pozitiviteti më i lartë është në muajin korrik (58%).

Numri më i lartë i testimeve në total është realizuar në **muajin korrik**, ku janë kryer në total **2717 teste** (mesatarisht 88 teste RT + PCR në ditë) ndërsa në muajin gusht është kryer numri më i lartë i testeve PCR (802 teste në total ose 26 teste mesatarisht në ditë) dhe numri më i lartë i testeve të shpejtë/Rapid test (**2418 teste në total** ose 78 teste mesatarisht në ditë);

Muaji me numrin më të ulët të testimeve në total është muaji nëntor me 381 testime dhe nëse e krahasojmë me vitin 2021 ku muaji me numrin më të ulët të testimeve në total ka qenë muaji maj me 1097 testime dhe më pas muaji qershor me 1189 testime.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet numrit të mostrave të marra RT, PCR dhe rasteve pozitive nga NJVKSH-të në tremujorët e vitit 2022. Nga tabela vihet re se:

	RT-PCR	RT PCR pozitiv	Testime RT	RT pozitiv	Testimetotal	RT+PCR pozitiv
<b>Tremujori I</b>	946	206	8786	2816	9732	3022
<b>Tremujori II</b>	664	256	1293	408	1957	664
<b>Tremujori III</b>	1580	986	4623	2353	6203	3339
<b>Tremujori IV</b>	255	33	1155	104	1410	137

**Tabela** – Raportimi i numrit të testimeve dhe testeve pozitive (për RT, PCR dhe RT+PCR) për periudhën janar- dhjetor 2022

Numri më i lartë i mostrave (RT+ PCR) është marrë në tremujorin e parë (**9732 mostra** në total, mesatarisht 108 mostra në ditë), ndërsa numri më i ulët është marrë në tremujorin e katërt (**1410 mostra**, mesatarisht 15 mostra në ditë) dhe nëse e krahasojmë me vitin 2021 vëmë re se numri më i lartë i mostrave (RT+ PCR) është marrë në tremujorin e parë (**7658 mostra** në total, mesatarisht 85 mostra në ditë), ndërsa numri më i ulët është marrë në tremujorin e dytë (**4120 mostra**, mesatarisht 45 mostra në ditë);



Numri më i lartë i mostrave që kanë rezultuar pozitive (RT + PCR) ka qenë në tremujorin III-të (**3339 mostra pozitive** ose mesatarisht *36 mostra pozitive në ditë*), ndërsa në vitin 2021, numri më i lartë i mostrave që kanë rezultuar pozitive (RT + PCR) ka qenë në tremujorin e I-rë (**3056 mostra pozitive** ose mesatarisht *34 mostra pozitive në ditë*). Numrimë i ulët i mostrave që kanë rezultuar pozitive ka qenë në tremujorin e IV-të (137 mostra ose mesatarisht *1.5 mostra në ditë kanë rezultuar pozitive*), ndërsa në vitin 2021, numri më i ulët i mostrave që kanë rezultuar pozitive ka qenë në tremujorin e II-të (420 mostra ose mesatarisht *4.6 mostra në ditë kanë rezultuar pozitive*); Numri më i lartë i mostrave RT-PCR është marrë në tremujorin e III-të (**1588 mostra** ose mesatarisht *17 mostra në ditë*) dhe numri më i ulët në tremujorin e IV-rt (**255 mostra** ose mesatarisht *2.8 mostra në ditë*) dhe nëse e krahasojmë me vitin 2021 vihet re se numri më i lartë i mostrave RT-PCR ka qenë në tremujorin e I-rë (**2968 mostra** ose mesatarisht *33 mostra në ditë*) dhe numri më i ulët në tremujorin e IV-rt (**1529 mostra** ose mesatarisht

*16.6 mostra në ditë*), pra dhe në 2021 dhe 2022 në tremujorin e IV-rt ka një rënie të numrit të mostrave të marra.

Numri më i lartë i mostrave RT është marrë në tremujorin e I-rë (8786 mostra ose mesatarisht *98 mostra në ditë*) dhe numri më i ulët në tremujorin e IV-rt (1155 mostra ose mesatarisht *12.7 mostra në ditë*);

Në tabelën e mëposhtme (nr.4) paraqiten dozat e vaksinave të aplikuara me secilën prej vaksinave të përdorura në Shqipëri, sipas Bashkive që ndodhen në territorin që mbulon NJVKSH Fier. Ngatabela vihet re se:

Bashkia	D1	D2	D3	D4	TOTAL
<b>Fier</b>	6982	11325	13824	3396	<b>35527</b>
<b>Patos</b>	921	1528	2286	712	<b>5447</b>
<b>Roskovec</b>	1395	2262	2901	1022	<b>7580</b>

**Tabela** – Raportimi i numrit të dozave vaksinë të aplikuara në bashkitë që ndodhen në territorin e NJVKSH Fier.

Në total për NJVKSH Fier janë aplikuar në total **48554 doza**, prej të cilave:  
*9298 doza të para*, ndërsa në vitin 2021 janë aplikuar **77929 doza**,  
*15115 doza të dyta*, ndërsa në vitin 2021 janë aplikuar **68760 doza**,  
*19011 doza të treta*, ndërsa në vitin 2021 janë aplikuar **15921 doza**,  
*5130 doza të katërta*, ndërsa në vitin 2021 janë aplikuar **0 doza**, pasi nuk kishte filluar ende aplikimi i dozës së dytë booster


## EVIDENCA E VDEKSHMËRISË FOSHJORE SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE

për 12- mujorin 2022

EMËRTIMI	12-mujori 2022					
	LINDJE	Vdekje		Rritjet	Gjiths	%o
		Fier				
<b>Lindje në Maternitet</b>						
<b>dhe mat. Q. Shëndetësore</b>	<b>1050</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>		<b>1.9</b>
<b>RRETHI</b>	<b>1032</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>4</b>		<b>3.9</b>
<b>BASHKITË</b>	<b>536</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
<b>Nj. Administrative të Fshatrave</b>	<b>496</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>4</b>		<b>8.06</b>
<b>Bashkia Fier</b>	<b>409</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Cakran</b>	<b>52</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>		<b>19.2</b>
Nj. Administrative <b>Mbrostar Ura</b>	<b>35</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Libofshë</b>	<b>23</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>		<b>43.4</b>
Nj. Administrative <b>Qendër</b>	<b>42</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Dërmënas</b>	<b>43</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Topoje</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>		<b>83.3</b>
Nj. Administrative <b>Levan</b>	<b>58</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>		<b>17.2</b>
Nj. Administrative <b>Frakull</b>	<b>49</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Portëz</b>	<b>57</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
<b>Bashkia Patos</b>	<b>87</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Zharrëz</b>	<b>34</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Ruzhdie</b>	<b>13</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
<b>Bashkia Roskovec</b>	<b>40</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Kuman</b>	<b>22</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Kurjan</b>	<b>14</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>
Nj. Administrative <b>Strum</b>	<b>42</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>		<b>0</b>

## NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR, LUSHNJE

INFORMACION PËR COVID-19 NGA JANARI DERI NË DHJETOR 2022



**Për vitin 2022 nga muaj Janar deri në Dhjetor 2022 në NjVKSh Lushnje janë aplikuar në total 20194 doza vaksinimi. Të ndara sipas dozave kemi:**

Doza të para janë aplikuar 3186

Doza të dyta janë aplikuar 4467

Doza të treta janë aplikuar 11083

Doza të katërta janë aplikuar 1458

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 ne Shëndetit Mjedisor janë kryer aktivitetet si më poshtë

Monitorimi i përditshëm i ujit të pijshëm Bashkia Lushnje

Monitorimi i përditshëm i ujit të pijshëm Bashkia Divjakë


Monitorimi i përditshëm i Autobote, të cilët tregtojnë uji të pijshëm në qytetin e Lushnjës.

Analizime të tjera

Monitorimi i kripës së jodizuar për përqendrimin e jodit .

Analiza ushqimore me kërkesë të bizneseve privat.

Buxheti



## **NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR MALLAKASTËR**

NjVKSh Mallakastër monitoron dhe menaxhon shërbimin shëndetësor të ofruar në **9 Qendrat Shëndetësore** të rrethit Mallakastër. Qendrat shëndetësore janë të shpërndara sipas njësive administrative, zonave rurale dhe fshatrave që secili banor të ketë akses shëndetësor në afërsi të vendbanimit të tij.

Popullsia e rrethit të Mallakastrës është **34 604** banorë në bazë të regjistrimit elektronik të mjekut të familjes.

Shërbimi shëndetësor i kujdesit shëndetësor parësor ofrohet në 9 qendra shëndetësore dhe në 34 ambulanca të shpërndara në nivel qyteti dhe qendër komune në rrethin e Mallakastrës.

Shërbimi shëndetësor mbulohet nga 13 mjekë familje dhe nga 65 infermierë.

Aktualisht janë vakante 7 pozicion pune mjek familje dhe 11 pozicione për infermierë. Kjo mungesë kaq e theksuar në personel shëndetësor do të thotë mbingarkesë për personelin ekzistues dhe ulje të cilësisë së shërbimit.

Si pasojë e një infrastrukture të vjetëruar dhe mungesës së rikonstrukcioneve prej kohësh ndërtesat e Ambulancave Belishovë, Ngraçie(QSH Qendër/Dukas), Damës (QSH Fratar) gjenden jashtë funksionit.

Ndërtesa e ambulancës Poçem është shembur si pasojë e tërmetit të muajit Nëntor 2019. Aktualisht shërbimi shëndetësor për banorët e zonës së Poçemit jepet në ambientet e shkollës 9 vjeçare në afërsi të saj.

Infermierët që japin shërbim shëndetësor pranë ambulancave Belishovës dhe Ngraçies, qëndrojnë në terren që të mbulojnë nevojat shëndetësore të banorëve të këtyre zonave .

Nga kushtet e dobëta higjieno-sanitare të gjendura veçanërisht në qendrat shëndetësore që mbulon një numër banorësh të lartë, vëmë në dukje për nevojën e shtimit të pozicionit të sanitares në strukturë.

Vëmë re një rritje të përqindjes së Check-Up të realizuar nga QSh-të e rrethit Mallakastër krahasuar me vitet paraardhëse. Gjatë vitit 2022 është realizuar kontrolli mjekësor bazë duke e tejkaluar normën e realizimit dhe duke regjistruar një përqindje realizimi prej 119 %.

Gjatë vitit 2022 në konsultoret e gruas pranë QSH-ve të rrethit Mallakastër janë kryer 571 vizita në total. Mjekët dhe mamitë, infermieret edukojnë nënat dhe femrat me këshillime për ndjekjen dietës së duhur gjatë shtatzënisë, mënyrat e parandalimit të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, konsumimin e jodit dhe hekurit e shtesave vitaminoze gjatë shtatzënisë. Personeli i konsultorit të gruas këshillon nënat që vizitat e kontrollit në një shtatëzani normale të kryhen rregullisht, si dhe në rastet kur gruaja është identifikuar me patologji të barrës si prezencë anemie, nefropatie apo rrezik dështimi është kontrolluar në intervale më të shpeshta nga mjeku dhe mamia e QSh. Në rastet e ekzaminimeve obstetrikale dhe analizave pacientja orientohet në maternitetet për tu konsultuar me mjekun obstetër që zakonisht ndjek edhe shtatzëninë deri në lindje.

**Gjatë vitit 2022 në rrethin Mallakastër janë lindur 94 fëmijë. Gjatë vitit 2022 janë akredituar 3 qendra shëndetësore, QSH Aranitas- 5 vjet, QSH Fratar-2 vjet dhe QSH Hekal-2 vjet.**

Total testime Covid-19 = **2,484**

Nr. i pacientëve rezultuar pozitiv = **1,109**


## INSPEKTORIATI SHETËTOR SHËNDETËSOR

Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është: “Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik”.

### PROGRAMI VJETOR I MIRATUAR PER VITIN 2022:

PLAN	FAKT		
NR. SUBJEKTEVE	1656	1643	
% E PLANIT TE PUNUAR	100 %	99.2 %	

### PËR VITI 2022 JANË KRYER 1795 INSPEKTIME DHE 2180 MONITORIME



### PROBLEMATIKAT E INSPEKTORIATIT SHETËTOR SHËNDETËSOR RAJONAL FIER:

Mungesa e ambienteve për ushtrimin e aktivitetit – prej 8 vitesh institucioni qëndron në 3 zyra të institucionit NJVKSH-FIER. Këto zyra përdoren gjithashtu për arshivim dokumentesh dhe magazinim materiale. Është emergjente zgjidhja përfundimtare e problemit pasi është i pamundur ushtrimi i aktivitetit në këto kushte.

Detyra e lënë nga Drejtoria e Arshivave për krijimin e ambienteve për arshivimin e dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi për arshivat.

Mungesa e ambiente për magazinimin e materialeve.

Mungesa e bazës materiale: kompjuter, printer, tablet, pajisje zyre.

### Fondi I Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Kontrolle në qendra shëndetësore të kontraktuara me Fondin u realizuan 29 në të cilat u vunë kushte penale në vlerën 267 000 lekë, dëme ekonomike 309 000 lekë dhe gjoba 18 000 lekë.

Gjatë vitit 2022 kanë marrë shërbimin e Hemodializës 110 pacientë në muaj me 14 435 seanca.

Check-up i realizuar për vitin 2022 është në masën 102 %.

## **DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR**

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier , ka zhvilluar aktivitetin e saj mbi bazën e Planit Vjetor 2021 të Miratuar nga DPSHSSH, mbi të cilën është programuar gjithë aktiviteti i drejtorisë me sektorët e saj:

I- Sektori i Pranueshmërisë

II- Sektori i Shërbimeve Sociale dhe IT

*Në muajin Janar 2022 ka pasur 2355 familje përfituese dhe në muajin Dhjetor 2022 2185 familje duke krahasuar Janar fillim viti Dhjetor fund viti kemi një rënie me 170 familje, kjo ka ardhur dhe si rrjedhojë e referimeve dhe punësimeve në saj të bashkëpunimit DRSHSSH Fier me AKPA Fier.*

Fondi vjetor i çelur për vitin 2022 për familjet që trajtohen me NE është 238,081,000 lekë krahasuar më 203'642'872 lekë për vitin 2021.

Kanë përfituar shpërblimin 3 muaj 2228 familje në bazë të VKM,754 me fond 6,684,000 total lekë, dhe për 6%, 213 familje me një fond prej 19,170,00 lekë.

Në bazë të VKM 899 kanë përfituar 199 familje me gra kryefamiljare me një buxhet 3.980.000 lekë dhe për familjet në ndihmë ekonomike janë 1651 familje me një buxhet 13,208,000 lekë dhe familjet me kategori të veçantë janë 281 familje me një buxhet 2,248,000 lekë. Me një fond në total 19,436,000.

Për vitin 2022 ishin planifikuar gjithsej 21 kontrolle, sipas Planit të Veprimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror. Nga 21 kontrolle të planifikuara janë realizuar 9 kontrolle, ndërsa 12 kontrolle nuk janë realizuar, kjo për shkak mungese stafi.

Fondi vjetor i çelur për vitin 2022 për familjet që trajtohen me PAK është 2,075,938,000 lekë krahasuar më 1,799,439,012 lekë për vitin 2021.

<i>Kategoritë</i>	<i>Paafhtësi</i>	<i>Verbëri</i>	<i>Paraplegji</i>	<i>Invalidë Pune</i>
<i>Indiv idë/f ondi total</i>	<i>5783 / 799 kujdesta rë</i>	<i>1696 / 396 kujdestarë</i>	<i>822 / 818 kujdestarë</i>	<i>6718</i>

Regjistri i ankesave për Ndhimën ekonomike dhe PAK 48 raste gjithsej nga të cilat:

- Info SHSSH 35 raste.
- Avokati i Popullit, dhoma e avokatisë dhe zyra përbarimore 17 raste.
- MSHMS 5 raste
- 150 raste të cilat janë sqaruar dhe adresuar.

Realizimi i buxhetit 2022 për NE dhe PAK është në masën

## **Në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura

Drejtoria Rajonale e Mjedisit

## **ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TË MBROJTURA**

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ka si mision monitorimin e vazhdueshëm dhe ruajtjen e gjendjes ekzistuese të zonave mjedisore të mbrojtura; menaxhimin e tyre në mbështetje të kërkesave të kohës dhe standardeve ndërkombëtare.

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ka si mision monitorimin e vazhdueshëm dhe ruajtjen e gjendjes ekzistuese të zonave mjedisore të mbrojtura; menaxhimin e tyre në mbështetje të kërkesave të kohës dhe standardeve ndërkombëtare.

### **Aktivitetet kryesore të realizuara për vitin 2022 në drejtim të menaxhimit të ZM-ve janë:**

- Menaxhimi dhe monitorim i vazhdueshëm për mbrojtjen e ZM dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në ZM
- Aktivitete edukimi dhe ndërgjegjësimi për mjedisin me shkollat që ndodhen brenda dhe jashtë ZM.
- Bashkëpunimi me Projektin JICA

- Promovim nëpërmjet televizioneve dhe materialeve informuese të vlerave natyrore, historike dhe të traditës së ZM .
- Organizimi i eventeve sensibilizues në kuadër të ditëve mjedisore.
- Marrja pjesë në takime me përfaqësues të Prefekturës Fier dhe bashkive Fier, Lushnje , Mallakastër, Divjakë mbi planin e masave të emergjencave civile dhe planit të masave për sezonin turistik 2022.
- Lidhja e kontratave me subjektet që operojnë në park dhe 2 zonat e mbrojtura
- Mire menaxhim për qendrën e vizitorëve .
- Zgjerimin e sipërfaqes pyjore të parkut në pjesët ranore ku janë lënë bosh pas tërheqjes së detit.
- Mirëmbajtje në ishullin e pelikanit për sezonin e çeljes së vezëve .
- Guida me turistë vendas dhe të huaj për promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të zonës
- Plotësimi i protokolleve të faunës së egër dhe numërimi periodik për çdo muaj .
- Mbrojtja nga zjarret duke ngritur grupet vullnetare të zjarreve me në krye kryeploqtë e fshatrave, përdorimi i kullave për vrojtimin nga zjarri .

### **Monitorimet**

- Parku Kombëtar Divjakë –Karavasta - 2429 monitorime
- PM Pish Poro- 465 monitorime
- RNM Levan - 146 monitorime
- PN Lugina e Lumit Vjosë – 143
- MN - 166 monitorime



## NUMRI I VIZITORËVE DHE TË ARDHURAT

Periudha: Janar-Dhjetor 2022

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta dhe PM Pishë Poro janë zona shumë të frekuentuara nga vizitorët vendas dhe të huaj, sidomos në periudhën e verës. Tabela e mëposhtme tregon në shifra numrin e vizitorëve të cilët frekuentuan këto zona gjatë 2022.

Nr	Qarku	Bashkia	Emërtimi i Zonës Mbrotur	Vendas	Të huaj	Numri Total	Të ardhura
1	Fier	Divjakë	Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta	345870	45440	391310	0
2	Fier	Fier	Bregdet Pishë Poro	207390	11140	218530	0
3	Fier	Fier	Levan	0	0	0	0
<b>Totali AdZM Fier</b>				<b>553260</b>	<b>56580</b>	<b>609840</b>	<b>0</b>

### PROBLEMATIKAT

1. Ngërçi administrativ me Bashkinë Divjakë .
2. Peshkimi pa kriter në Lagunën e Karavastës është një tjetër problematikë.
3. Lidhja e kontratave me subjekte që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Park .
4. Vakumi ligjor i ligjit 81/2017(mungesë e akteve n/ligjore)
5. Saktësimi i kufijve në RNM Pish Poro dhe RNM Levan, plotësimi me hartat treguese.
6. Mungesa e një listë pronarësh brenda territorit të ZM Qarku Fier.
7. Mungesë bashkëpunimi me zyrën e kadastrës.
8. Tentativat për ndërtime pa leje, zënie të fondit pyjor për përfitim ekonomik.
9. Ndotje e ujërave në kanalet brenda Zonës së Mbrojtur por edhe në 2 emisarët që përshkojnë parkun, por ndotja “trashëgohet” që nga origjina e tyre.

#### Të tjera

- **Mungesë karburanti ( ulje e numrit të monitorimeve)**

Gjatë vitit 2022 një problem serioz i cili dha impakt direkt në punën tonë të përditshme është reduktimi i sasisë së karburantit për mjetet ( makina dhe motorët). Kjo mungesë e karburantit ndikoi në mosrealizimin e objektivave të planifikuara në planin vjetor 2022, në ulje të numrit të kontrolleve. Theksojmë se prej 2022 nën administrimin e AdZM Fier

është edhe zona e PN Lugina Lumit Vjosë, pra një sipërfaqe akoma më e madhe për tu menaxhuar.

## AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT, FIER

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë ushtron funksionet e saj në këto tre qarqe.

### ❖ Fusha e Veprimtarisë dhe Objektivat

- Mbikëqyr dhe mbron territorin e të gjithë rajonit
- Organizon punën e ARM-së dhe shpërndan detyrat sipas objektivave specifike të secilit punonjës;
- Bashkëpunon me ARM-të e tjera dhe mbështet punën e AKM-së në lidhje me aplikime, monitorime, inspektime që kanë të bëjnë me rajonin përkatës;
- Harton programin vjetor të inspektimit dhe ja dërgon për miratim Drejtorit të ARM-së.

### ❖ Sektori i inspektimit mjedisor

ka realizuar objektivat si më poshtë:

SEKTORI I INSPEKTIMIT MJEDISOR			
Inspektime Janar - Dhjetor 2022	Procedura Asgjësimi	Ankesa	Inspektime jashtë programit
<b>66</b>	<b>00</b>	<b>05</b>	<b>17</b>

### ❖ Sektori i lejeve mjedisore

ka realizuar objektivat si më poshtë:

Dhënie për mjedisi A dhe B	Mendimi leje	Dhënie për Paraprake/Thehlluar	Mendimi VNM	Aplikime për Dëgjesë me publikun
<b>190</b>		<b>291</b>		<b>133</b>

### ❖ Sektori i inspektimit të burimeve natyrore dhe ujërave

Ka realizuar objektivat si më poshtë:

- Përpunim të database për subjektet e pajisur me leje shfrytëzimi të burimeve ujore për të 3 Qarqet
- Evidentim të zonave dhe subjekteve që bëjnë shkarkime të ndryshme në mjedise të ndryshme
- Sensibilizim i shoqërisë mbi situatën pandemike në vend

SEKTORI I INSPEKTIMIT TE BURIMEVE NATYRORE DHE UJRAVE		
Inspektime total	Masa administrative	Ankesa
32	1	2

❖ **Sektori i monitorimit**

Sektori i Monitorimit ka vlerësuar që të gjitha monitorimet që kanë ardhur gjatë gjithë vitit nga subjektet kanë qenë brenda kushteve të lejeve mjedisore.

**Problematikë mbetet : Menaxhimi i mbetjeve.**

**1. ZYRA E ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT TË PARQEVE ARKEOLOGJIKE**

Parqet Arkeologjike Apoloni dhe Bylis kanë patur një vit të suksesshëm në vijueshmëri dhe realizimin e shërbimeve ndaj vizitorëve dhe monumenteve.

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR VIZITORËT 1 JANAR - 31 DHJETOR 2022

NR	Emërtimi	Vizitorë vendas	Vizitorë të huaj	Vizitorë me biletë	Vizitorë pa biletë	Totali i vizitorëve	Totali / lekë
1	Parku Arkeologjik Apoloni	15348	27887	43234	9010	52244	21755100
2	Parku Arkeologjik Bylis	1624	1300	2924	777	3701	940380

**2. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Rajoni II, Vlorë Sektori Inspektimit Fier**

Për muajt Janar- Dhjetor 2022 kanë qenë të angazhuar në inspektime 6 inspektorë, 3 që kanë punuar gjatë gjithë vitit dhe 3 që kanë punuar një pjesë të vitit. Kanë qenë të planifikuara për inspektim 536 subjekte. Në total për muajt Janar- Dhjetor 2022 raportohen 607 subjekte me 10385 punëmarrës. Janë kryer: 536 inspektime të programuara, 9 inspektime për shkak ankese , 14 inspektime për shkak aksidenti të ndodhur në punë, 46 inspektime të bëra me kërkesë nga subjekti nëpërmjet sistemit e-Albania për aplikim në projektin IPARD II/AZHBR, 1 inspektim me kërkesë të subjektit për leje pune para fillimit të aktivitetit dhe 1 inspektim rastësor.

Sipas ndarjes së ILO – 9 llojeve të aktiviteteve janë kryer këto inspektime Sektori i Inspektimit Fier.

Subjekte me aktivitet Bujqësi, Pyje, Peshkim.	27
Subjekte Miniera dhe Karriera.	3
Subjekte me aktivitet Ndërmarrje Prodhuese.	209
Subjekte Elektricitet, Gaz, Ujë.	3
Subjekte me aktivitet Tregëti me shumicë dhe pakicë B-R-H.	213
Subjekte në Ndërtim.	70
Subjekte në Transport ,Magazinim Komunikacion.	28
Subjekt Financë ,Shërb. të Sig. Të Biznesit dhe Komunale.	1
Subjekte në Aktivitete të Tjera	53

Janë evidentuar gjithsej 10385 punëmarrës , nga këta 5449 femra. Në subjektet që janë kontrolluar kryesisht me aktivitet tregëti dhe prodhim janë evidentuar punëmarrës të cilët punojnë mbi kohën normale javore max. të punës, janë lënë detyra në zbatim të neneve 81,87,91 të Kodit të Punës për shtesa në pagën mujore.

Janë evidentuar 32 punëmarrës informalë të cilët janë futur të gjithë në skemën e sigurimeve shoqërore, janë evidentuar 10 shtetas të huaj, punëmarrës nën 18- vjeç janë evidentuar 12.

### **Problematikat e konstatuara gjatë inspektimeve në muajt Janar - Dhjetor 2022 janë :**

Ka patur raste të mos pagesave në kohë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.  
 Ka mangësi në dhënien e pagës nëpërmjet sistemit bankar.  
 Janë evidentuar punëmarrës pa kontrata individuale.  
 Ka mangësi në vënien në dispozicion të punëmarrësve të dokumentit të përlllogaritjes së pagës.  
 Mangësi në ekzaminimin shëndetësor fillestar dhe periodik të punëmarrësve.  
 Mangësi në plotësimin e dokumentacionit të punëmarrësve.  
 Mungon dokumenti i vlerësimit të rrezikut.  
 Janë evidentuar 4 punëmarrës informalë.  
 Gjatë muajve Janar - Dhjetor 2022 nuk janë evidentuar raste të Sëmundjeve Profesionale.  
 Bashkëpunim me Organizata Sindikale nuk ka patur.

### **Takimet me degët territoriale :**

- Datë 02.02.2022 organizimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier të takimit me Inspektoratin Shtetëror të Punës, Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional dhe Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore.

- Datë 08.02.2022 organizimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier të takimit me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Shërbimin Kombëtar të Veterinarisë dhe Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.
- Datë 17.02.2022 organizimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier të takimit me Ministrinë e Brendshme dhe organizatën IOM.
- Datë 27.05.2022 organizimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier të takimit me Drejtoreshën e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Rajonit Jugor.
- Datë 08.07.2022 organizimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier të takimit me Drejtuesit e Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier, Lushnje, Mallakastër në lidhje me rritjen e rasteve të Covid – 19.
- Datë 12.07.2022 organizimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier të takimit me degët territoriale të qarkut në lidhje me analizën 6- mujore.
- Datë 15.12.2022 organizimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier të takimit me degët territoriale të qarkut në kuadër të festave të fundvitit dhe masat e marra.

## Investimet sipas Bashkive :

### Bashkia Fier

Ndërtim I pikës së transferimit të mbetjeve	1110277	19,176,762	19,175,520
Mirëmbajtje me sisit. vaditje automatik i sipërfaqeve te gjelbërta dhe skarpateve buzë lumit Gjanica nga Ura me shkalle deri shkolla jopublike B shkencës	1110300	5,641,461	4,920,000
Rehabilitim i segmentit te 2 te Rr. J. Mile ,faza2	1110279	13,667,637	1,593,075
Ndërtim fasada qendra multifunksionale për te rritur e fëmijë	1110272	1,959,174	1,959,174
Rehabilitim 1 Unazës Skënderbej Unaza jugore BF	1110294	7,575,429	7,575,429
Sistemi i vaditjes dhe pusi per gjelbërimin spitali Memorial BF - 3869846, iaah-33722M	1110298	7,242,134	7,024.86
Ndarje tualete pallati i sportit	1110306	1,195,000	
Blerje projekti Rehabilitim Diga rezervuari Libofshe ( është 230)	1110307	1,200,000	252,000
Ndërtim i shpatullave të urës VLF km 7890 njësia Cakran buxhet shitesë	1110311	1,630,954	
Gjithsej investime programi 0 1110		375,763,927	161,565,558
Shpronësime programim 0 4520 BF		9,204,762	74,868
<b>shuma Aparati</b>		384,968,689	161,640,426
Rikonstruksion shkolla N. Kacsaku		2,693,202	2,588,626
Bashkëfinancim/Rikonstr I shkollës N. Frashri			
Ndërtim i shkollës 9-vjccarc Darëzezë e re		8,615.59	8,615,587
Pajisje për lojërat me dorë vkb 07.22		10.000,000	
shuma programi 09J20		21.308,789	11.204,213
shuma program 10130		4,000,000	0
Rikonstruksion qendra shëndetësore			
<b>Totali Bashkia Fier</b>		410,277,478	172,844,639

<b>Emërtimi</b>	<b>Plan</b>	<b>Kaluar 2022 Ne bruto</b>
<b>Buxheti i shtetit</b>	<b>Totali plan</b>	
Ndërtim I sistemit te trajtimit dhe largimit te ujerave te përdorura të Spitalit Memorial Fier	<b>18.893.429</b>	<b>18,893,429</b>
Ndërtim Ujësjetllësi ne DMA A6 dhe Ujësjetllësi.ne zonën Afrim i Ri shkolla Bujqësore	<b>50.000.000</b>	<b>50,000,000</b>
Shpronësime nga projekti "rehabi, I Lumit Gjanica, "Rikon. i Qendrës së Qytetit" 'dhe "Ndërtimi I stadiumit	<b>8,808,851</b>	<b>8,808,851</b>
Mbikëqyrje e punimeve të objektit "Ndërtim I sistemit te trajtimit dhe largimit te ujerave te përdorur te SM,	<b>230,687</b>	<b>230.687</b>
Rehabilitim I kanalit Ujitës Dega Fier	<b>4,183,368</b>	<b>4,183,368</b>
Mbikëqyrje për objektin Nder Ujësjetllësi ne DMA A6 zona Afri I Ri shkolla Bujqësore	<b>200,000</b>	<b>200,000</b>
<b>Totali</b>	<b>82,316335</b>	<b>82316335</b>
<b>Totali përfundimtar</b>	<b>492,593,813</b>	<b>255,160,974</b>

 **Bashkia Mallakastër**

<b>Nr.</b>	<b>Investime nga buxheti i shtetit për vitin 2022</b>	<b>Investime nga buxheti i shtetit të realizuara në vitin 2022</b>	<b>Investime nga buxheti i shtetit në proces për vitin 2022</b>
1	Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh		Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh
2	Ndërtim linje transmetimi rrjeti i jashtëm ujësjetllësi Rajonal (Nga burimi I Poçemit)		Ndërtim linje transmetimi rrjeti i jashtëm ujësjetllësi Rajonal (Nga burimi I Poçemit)
3	Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pa favorizuara	Përmirësimi i kushteve të banimit në ndërtesa, për komunitetet e pa favorizuara	
4	Studim projektim të objektit: Ndërtim i ujësjetllësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë	Studim projektim të objektit: Ndërtim i ujësjetllësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë	
5	Studim projektim të objektit: Ndërtim i ujësjetllësit të fshatrave të NJA Aranitas	Studim projektim të objektit: Ndërtim i ujësjetllësit të fshatrave të NJA Aranitas	

Investimet 2022								
Objekti	Numri Referencës	LLoji i Procedurës së Prokurimit	Fondi Limit	Operatori Ekonomik Fitues	Vlera Kontratës (me TVSH)	Mbikqyrësi	Vlera e Mbikqyrjes	Kolaudatori
Sistemin asfaltim i rrugës Shpresa + rrugës së Repartit në Zhamë Sektor	REF-27742-05-06-2022	E hapur	20 298 015.36	"ENI" SHPK & "FLED" SHPK	12 852 591.6	"PROJECT DALUZ 2019" shpk	152 102.76	
Sistemin asfaltim i rruges " Jakov Xoxa " dhe vazhdimi pas unazes	REF-34084-06-23-2022	E hapur	20 999 984.4	"SHKELQIMI 07" shpk	12 000 025.2	"A R G I" shpk	142 013.16	"G & L Construction"
Rehabilitim i palestres, Shkolla "Foto Puka"	REF-44549-10-05-2022	E hapur	29 851 955	"ZDRAVO" & "TOTILA " SHPK	26 065 008	"A R G I" shpk	337 780.8	
Rikonstrukcion i rrugës Cekeve dhe Pajolli në fshatin Kashëbardhë	REF-45152-10-10-2022	E hapur	17 876 206.8	"BEQIRI" shpk	12 892 449.6	"G & L Construction" shpk	155 532.44	
"Ndërtimi i murit mbajtës përgjatë pallateve në lagjen Kongresi i Lushnjes"	REF-49663-11-11-2022	E hapur e thjeshtuar	4 423 477.2	"NGRACAN 1934"	4 199 076	"G & L Construction" shpk	100 800	
"Rehabilitim i kanalit të ujërave të larta në lagjen Kongresi i Lushnjes"	REF-45384-10-11-2022	E hapur	17 854 573.2	"2 N" shpk	11 719 878	"G B Civil Engineering" shpk	257 837.32	
Ndërtimi i tregut në lagjen " Xhevdet Nepravishta"	REF-22598-03-18-2022	E hapur	35 140 215.96	"NIKA" shpk	28 371 642.5	"PROJECT DALUZ 2019" shpk	314 816.5	
Ndërhyrje në infrastrukturen e rrugëve "Vasilika Gogu" dhe "Hysen Dervishi"	REF-40255-08-30-2022	E hapur	19 508 342.4	"K.M.K" & "CAUSHI" shpk	11 424 999.6	"G B Civil Engineering" shpk	139 027.97	
Sistemin asfaltim i segmentit rrugor " Taulla Sinani - Esmat Dervishi "	REF-36235-07-13-2022	E hapur	27 723 386.4	"Company Riviera 2008 "shpk	18 491 131.2	"INDAY-18" shpk	203 657.16	
Ndërhyrje në infrastrukturen e rrugës "Unaze e ish depos së duhanit	REF-36236-07-13-2022	E hapur	34 470 422	"ZDRAVO" SHPK	25 301 537.1	"INDAY-18" shpk	259 774.44	
Rikonstrukcion i shkollës 9-vjecare "Skender Libohova" + shtese anesore, Lushnje	REF-43377-09-26-2022	E hapur	69 800 749.2	"ZDRAVO" & "TOTILA " SHPK	55 141 750.8	"REAN 95" shpk	800 407.2	



## **Bashkia Divjakë**



Investimet nga buxheti i shtetit, të infrastrukturës dhe projekte urbane që keni të planifikuara për vitin 2022, të realizuarat dhe ato që janë ende në proces :

- “Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njesisë Administrative Remas, Loti I Njësia Administrative Remas” – Në proces
- “Ndërtim palestre e mbuluar dhe rikonstruksion I shkollës së Mesme të Bashkuar, Cermë Sektor, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë” – Në proces
- “Ndërtimi i godinës së Bashkisë Divjakë” – Në proces
- “Sistemim Asfaltim I Rrugëve të Cermës Bashkia Divjakë”- Përfunduar
- “Përmirësim i shtresave rrugore në rrugën e Petrollarëve Fshati Këmishtaj”- Përfunduar
- “Impianti I trajtimit të ujërave të ndotura dhe sistemi I kanalizimeve” – Në proces
- “Rikonstruksioni I shtëpive të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore” – Në proces

# Bashkia Patos

BASHKIA PATOS

EVIDENCA E REALIZIMIT TË INVESTIMEVE BASHKIA PATOS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2022

Pasqyra nr. 3

Njesite e Qeverisjes Vendore / Institucionet	Emertimi i objektit	Fondi i akorduar 2022	Burimi i financimit	Planifikuar për periudhen (dt. fillimit dhe dt. mbarimit)	Vlera e prokuruar	Realizimi progresiv		Shënime
						Vlera	%	
Infrastruktura	FV kangiella metalike bordura mbrojtese	731,400	Nga te ardhurat vendore	2022	731,400	731,399	100	
Infrastruktura	Blerje baze materiale per ndertimin e murit ne rrugen Demokracia	157,680	Nga te ardhurat vendore	2022	157,680	157,680	100	
Infrastruktura	Ndricim rrugor (Baze materiale)	14,407,644	Nga te ardhurat vendore	2022	14,407,644	14,407,644	100	
Bordi i Kullimit	Rehabilitim i rrjetit Ujtes Beline	9,566,836	Nga Transferta Specifike	2022	9,566,836	9,566,835	100	
Infrastruktura	Blerje Baze Materiale per Rikonstruksionin e Rrethimit te varrezave Publike 1,2dhe zgjerimin e rrugeve te Brendshme	1,658,616	Nga te ardhurat vendore	2022	1,658,616	1,658,616	100	
Infrastruktura	Rikonstruksion dhe shtrim me asfalto beton te rruges Xhepaj Siquece	10,079,224	Nga te ardhurat vendore	2022	10,079,224	10,079,224	100	
Arsini	Rikonstruksion i ambjenteve te kopshtit te femijeve Qender Zharrez dhe sistemimi I hapësirave publike	2,711,048	Nga transferta Specifike	2022	2,748,534	2,746,201	100	
Ndertese	Rehabilitim i pjesshem I godines NJ.Zharrez dhe dhomat e zhveshjes se fushes se sportit zharrez	5,654,967	Nga te ardhurat vendore/Grant	2022	5,654,967	5,654,881	100	
Ndertese	Rikonstruksion i ambjenteve te Shk.Sotir Capo ne adaptim Kopesht per femije	3,056,365	Nga transferta e pakushtezuar	2022	3,056,365	3,026,809	99	
Pajisje	Blerje pajisje per sallën e boksit	636,000	Nga transferta e pakushtezuar	2022	636,000	636,000	100	
Infrastruktura	Blerje baze materiale per Zgjerim rrjetit KUZ ne lagj 29 Marsi	719,124	Nga te ardhurat vendore	2022	719,124	719,124	100	
Infrastruktura	Sistemi i rivitalizimit i minibroqeve L.Re dhe L.Naftetari (vazhdim nga 2021)	1,493,702	Nga te ardhurat vendore	2021-2022	1,493,702	1,493,702	100	
Infrastruktura	Sistem hapësirave publike dhe parkim pas bllokut te ish bashkise	2,575,740	Nga te ardhurat vendore	2021-2022	2,575,740	1,545,960	60	
Infrastruktura	Sistimi I hapësirave ne lagjen 29 marsi,te Zjarrfiksj	7,485,874	Nga te ardhurat vendore	2021-2022	7,485,874	7,485,874	100	
Pajisje	Blerje pajisje zyre per Administraten	957,600	Nga transferta e pakushtezuar	2022	957,600	957,600	100	
Mjet pune	Blerje Miniekskavator per Bordin e Kullimit	5,496,000	Nga Transferta Specifike	2022	5,496,000	5,496,000	100	
Projekte	Studim projektim per Ujite Kullimin	454,545	Nga Transferta Specifike		454,545	454,545	100	
Infrastruktura	Rikonstruksion dhe shtrim me asfalto beton te rruges Fshati I Ri Sheqishte	16,819,618	Nga te ardhurat vendore	2022-2023	16,819,618	14,341,601	85	
Pajisje	Panel diellor si dhe pajisje te tjera per Sportin	719,260	Nga transferta e pakushtezuar	2022	719,260	719,260	100	
Ndertese	Rikonstruksion I shkolles "Muhamet Shehu" dhe ndertim i Palestres.	5,723,674	Nga te ardhurat vendore	2022	5,723,674	-	0	
Ndertese	Rikonstruksion i Qendres Shendetesore Rruzhdie dhe AMBULANCES DUKAS (BASHKEFINANCIM 34%)	4,310,463	Nga transferta e pakushtezuar	2022	4,310,463	-	0	
Ndertese	Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë (Bashkëfinancim 30% )	4,958,557	Nga te ardhurat vendore	2022	4,958,557	-	0	
Infrastruktura	Blerje Baze Materiale per Nderim te trotuareve	9,194,016	Nga te ardhurat vendore	2022	9,194,016	-	0	
Infrastruktura	Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova,degëzim i rruges Late Bregu" te pallatet dy katësh"	30,588,574	Nga te ardhurat vendore	2022	30,588,574	-	0	
Infrastruktura	Rikonstruksion dhe shtrim me asfalto beton te rruges Banaj	19,283,646	Nga te ardhurat vendore	2022-2023	19,283,646	-	0	
					-	-	#DIV/0!	
	<b>Total investime nga fondet e buxhetit</b>				<b>67,879,851</b>	<b>81,878,955</b>		-
Njesite e Qeverisjes Vendore /	Emertimi i objektit	Fondi i akorduar 2022	Burimi i financimit	Planifikuar për periudhen (dt. fillimit dhe dt.	Vlera e prokuruar	Realizimi progresiv		Shënime
						Vlera	%	
Infrastruktura	Rikonstruksion i Magjistratit Kryesor te Ujesjellesit Loti I	136,730,000	Ministria e Infrastruktures dhe Energji	2020-2024	136,804,725	136,600,001	100	
Ndertese	Rikonstruksion i Magjistratit Kryesor te Ujesjellesit Loti II	20,200,000	Ministria e Infrastruktures dhe Energji	2021-2024	20,200,000	20,124,522	100	
Ndertese	Rikonstruksion i shkolles "Muhamet Shehu" dhe ndertim i palestres	32,434,150	Ministria e Arsimit	2022-2023	32,434,150	32,434,150	100	
Ndertese	Përmirësimi I banesave ekzistuese per familjet ne nevojë	8,239,582	Ministria e Financave	2022-2023	8,239,582	8,239,522	100	
	<b>Total investime nga fondet e SHTEJTT</b>				<b>197,678,457</b>	<b>197,398,195</b>		
<b>Shuma totale e investimeve Janar-Dhjetor 2022</b>					<b>265,558,308</b>	<b>279,277,150</b>		



## Bashkia Roskovec

Informacion mbi investimet per gjate vitit 2022 nga Bashkia Roskovec					
Nr	Emertimi I Projektit	Vlera e projektit	Burimi i Financimit	Faza Aktuale e projektit	Afati i perfundimit
1	Permiresimi funizimit me uje te Njesise Administrative Strum Rikonstruksioni i ujesjellsitte fshatit Suk 1,Suk 2, Strum, Velmisht	221,987,872	Buxhet i shtetit	Ne proces	06.04.2023
2	Rikonstruksioni i bibliotekes Publike Roskovec dhe krijimi i klubit Rinore te librit	1,638,096	Mnistria e Shtetit per Rinine dhe femijet	Perfunduar	
3	"Rikonstruksioni i Rruges Musa Sinani - Struga e Thate Suk 2	5,135,501	Te ardhurat e Bashkise	Perfunduar	
4	Blerje materia per sinjalistiken rrugore per Ndermarrjen e sherbimeve te Mirembatjes	840,000	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	
5	" Fuqizimi i stacionite pompimit te ujitjes nga lumi Seman, zona e suk - Hoxhenje"	2,614,284	Emergencat	Ne proces	
6	Pastrimi, sistemimi dhe mbulimi me tumbino i kanalit K 25 permes fshatit Marinez	10,599,971	Bankers Petroleum Albania LTD	Perfunduar	
7	"Hartim i projekt zbatimit per bllokun nr 3"	806,518	Te ardhurat e Bashkise	Perfunduar	
8	Rruga "Bullazaret" 400 ml. +rruga "Doksaneve" 150 ml, fshati Kurjan ( b=4m rerebituminoze + 2*0.5 bankina	4,953,600	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	11.03.2023
9	Rikonstruksioni i rruges "Zogallaret" fshati Suk 2, 600 ml +rruga "Asllan Toska 670 ml, + rruget lidhese 189 ml b = 4 m rerebituminoze + 2*05 m bankine	3,750,816	Te ardhurat e Bashkise	Perfunduar	
10	Rikonstruksioni i rruges lagjia "Dortaj", fshati Vlosh	4,598,772	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	13.03.2023
11	Rikonstruksioni i rruges Vidhishte-Kerranjaket,fshati Luar ,2060ml, b=4m rerebituminoze + bankina 2*0.5m	5,192,040	Te ardhurat e Bashkise	Perfunduar	
12	Permiresimi i banesave ekzistuese	11,441,918	Buxhet i shtetit+Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	18.04.2023
13	Rikonstruksioni i rruges "Shehallaret" Roskovec	7,361,208	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	10.04.2023
14	Rikonstruksioni i rruges "Metushaj" Suk 1	3,799,200	Te ardhurat e Bashkise	Perfunduar	
15	Rikonstruksioni i rruges "Zyka" Kuman	5,126,820	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	30.04.2023
16	Asfaltim trotuar + ndricim "Qani Kapo" Jagodine	5,453,784	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	10.05.2023
17	Rikonstruksioni i rruges "Shyqo Refati +Bashkimi Strum	5,329,920	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	14.03.2023
18	Rikonstruksioni i rruges "Kadri Ruko" Strum	6,451,906	Te ardhurat e Bashkise	Perfunduar	
19	Nderhyrje emergjente ne fshatin Ngjeqar	60,765,201	AKMC	Ne proces	12.10.2023
20	Sistemimi i qendres se Mbersit dhe i godines per sherbime komunitare	3,198,908.4	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	18.02.2023
21	Rikonstruksioni i rruges Feta Agaci ( Mulliri) Suk 1	3,709,227.6	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	30.04.2023
22	Rikonstruksioni i rruges Cezmes	5,564,160	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	02.02.2023
23	Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare Suk 1	80,738,993	Buxhet i shtetit+Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	
24	Rikonstruksioni catis se shkolles 9 vjecare Kuman	3,726,480	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	10.02.2023
25	Asfaltim i rruges Faik Kapo Roskovec	3,734,424	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	17.02.2023
26	Rikonstruksioni i rruges Vidhishte Drize	10,810,800	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	10.04.2023
27	Sistemimi i qendres Marinez + ndertimi i rrethrotullimit	11,981,976	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	10.05.2023
28	Permiresimi i rrugeve te lagjeve dhe parcelave bujqesore	2,796,240	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	05.03.2023
29	Nderthyrtje emergjentene infrastrukture per mbrotje nga fatkeqesite natyrore sipas objekteve . Punime per veshjen e kanalit V-35 dhe portat hyrse ne V3, Punime per puseten e thithjes se stacionit te pompimit Hoxhenjt, Punime per hapjen e rruges ne pyellin e Vloshit	3,295,327	Emergencat Civile	Ne proces	12.03.2023
30	Rikonstruksioni I KUL Roskovec	2,742,900	Te ardhurat e Bashkise	Ne proces	01.02.2023

1. **Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve Qendrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2022, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të veçanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjienës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.**

**Ky objektivi u realizua nëpërmjet:**

- Ngritjes së grupit të punës me anëtarë të degëve territoriale për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik.
- Drejtimi i Komitetit Rajonal të Turizmit

**Konkretisht :**

Për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik 2022, Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, i kushtoi një vëmendje të veçantë koordinimit dhe monitorimit të punës të Institucioneve Qendrore në nivel vendor që kanë impakt në mbarëvajtjen e sezonit, për këtë krahas punës së vazhduar gjatë gjithë vitit me mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve Komiteti Rajonal I Turizmit me përfaqësues të drejtorive të Qarkut Fier si dhe me përfaqësues të nivelit qendror (Ministria e Turizmit) është mbledhur 2 herë përkatësisht në datat 25.02.2022 përpara fillimit të sezonit turistik si dhe në datën 27.06.2022. Në të dyja këto takime janë diskutuar tematika të rëndësishme të turizmit, çfarë duhej përmbushur përpara hapjes së sezonit turistik veror 2022, problematikat që mund të haseshin, çfarë mund të bëhej për ti zgjidhur përpara fillimit të punës, si dhe në takimin e fundit është diskutuar ecuria e punës, cilat janë problematikat të cilat ende nuk po gjejnë zgjidhje, janë sqaruar detyrat e përcaktuara në Urdhërin e Kryeministrit nr. nr.83 datë 11.05.2022 “Për ngritjen e Task-Forcës ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2022” përfshirë “Plani i masave i miratuar për sezonin turistik veror 2022”. Nga ana e drejtorive të cilat kishin detyra specifike për turizmin u bë një raportim javor për menaxhimin e sezonit turistik, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier dhe ky raportim u përpunua dhe u raportua në Ministrinë e Brendshme çdo ditë të Premte.

2. **Ndjekja e veprimtarisë së organeve vendimmarrëse të NJVQV-ve, akteve normative të nxjerra prej tyre, nivelin juridik dhe funksional, nivelin e komunikimit me publikun dhe transparencën. Koordinimi i punës ndërmjet Institucioneve rajonale për zhvillimin e konsultimeve me NJVQV-të për politikën, legjislativën dhe normat që ndikojnë drejtpërdrejtë në realizimin e funksioneve të NJVQV-ve.**



**Ky objektivi u realizua nëpërmjet:**

-inkurajimit të NJVQV--të për të qenë të përgjegjshme ndaj qytetarëve në ofrimin e shërbimeve dhe transparente në menaxhimin e burimeve të tyre financiare. Gjithashtu politikën dhe strategjitë e ndjekura nga Institucionet Rajonale të synojnë harmonizimin me normat e ndjekura nga NJVQV-të dhe anasjelltas për të arritur qëllimet e përbashkëta me qëllimin final shërbimi ndaj qytetarit

**Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier** ka ndjekur ecurinë e zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, bazuar në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

Qarku Fier përbëhet nga 6 bashki të cilat tashme kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, dhe gjatë viti 2021 janë kryer 3 Rishikime të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të Përsheptuar: Bashkia Fier (1) dhe Bashkia Roskovec ( 2 )

- Është kryer kontrollin Periodik i Zhvillimeve në Territor për të gjashtë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Ky kontroll kryet në muajin Mars te çdo viti, për vitin paraardhës.
- Plani i përgjithshëm vendor zbatohet nëpërmjet Planeve të Detajuara Vendore - PDV

	Bashkia Fier - 2PDV Bashkia Lushnje - 4 PDV	Bashkia Mallakastër Bashkia Patos Bashkia Divjakë Bashkia Roskovec	
-----------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------

#### ❖ Investimet nga Buxheti i Shtetit ne Qarkun Fier

*Bashkia FIER*

- Ndërtimi i sistemit të trajtimit dhe largimit të ujrave të përdorura të Spitalit Memorial Fier
- Ndërtim Ujësjetësi në DMA A6 dhe Ujësjetësi në zonën Afrim i Ri-Shkolla Bujqesore
- Shpronësime nga Projekti i "Rehabilitim i Lumit Gjanicë,Rikonst. i Qendrës së Qyetit dhe Ndërtimi i Stadjumit
- Mbikqyrje e punimeve të objektit " Ndërtimi i sistemit të trajtimit të ujrave të përdorur të Spitalit Memorial
- Rehabilitim i kanalit Ujites Dega Fier
- Mbikqyrje për Objektivin Ndertim Ujesjetësi ne DMA A6 Zona Afrim i Ri -Shkolla Bujqesore

**Bashkia DIVJAKË**

- Furnizimi me ujë për zonat Bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Nj.Ad.Rremas, Loti I Nj.Ad.Remas- në proçes
- Ndërtim palestre e mbuluar dhe rikonstruksioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar , Çermë Sektor, Nj.Ad. Tërbuf, Bashkia Divjakë- në proçes
- Ndërtimi i godinës së Bashkisë Divjakë- në proçes
- Sistemim asfaltim i rrugëve të Çermës, Bashkia Divjakë - përfunduar
- Përmirësimi i shtresave rrugore në Rrugën e Petrollarëve, Fshati Këmishtaj- përf.
- Impianti i trajtimit të ujrave të ndotura dhe sistemi i kanalizimeve -në Proçes
- Rikonstruksioni i shtëpive të dëmtuara nga fatkeqsitë natyrore

**Bashkia LUSHNJE**

- Rehabilitim i Palestrës, Shkolla "Foto Puka "
- Ndërtim i murit mbajtës përgjatë pallateve ne Lagjien "Kongresi i Lushnjes "
- Rehabilitim i Kanalit të Ujrave të Larta në lagjien "Kongresi i Lushnjes"
- Rikonstruksioni i shkollës vjeçare "Skënder Libohova " +Shtesë Anësore

**Bashkia ROSKOVEC**

- Përmirësimi furnizimit me uje të NJ.Ad. Strum , rikonstruksioni i ujësjellesit te Fshatit Suk 1 , Suk2 , Strum , Velmisht
- Fuqizimi i Stacionit të Pompimit të Ujitjes nga Lumi Seman , zona Suk-Hoxhenj
- Përmirësimi i banesave ekzistuese ( Buxheti i Shtetit + Buxheti i Bashkisë)
- Ndërhyrje emergjente infrastrukture për mbrojtje nga fatkeqsitë natyrore

**Bashkia PATOS**


- Rikonstruksioni i magjstralit kryesor të Ujësjesit Loti I
- Rikonstruksioni i magjstralit kryesor të Ujësjesit Loti II
- Rikonstruksioni i Shkollës "Muhamet Shehu" dhe ndërtimi i Palestrës
- Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë

- Rikonstrukcion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh.
- Ndërtim linje trasmetimi i rrjeti i jashtëm ujësjëllsi Rajonal (nga burimi Poçemit).
- Studim projektim të objektit: ndërtim i ujësjëllësit të fshatrave Drenovë, Belishovë, Belistan dhe Visokë.
- Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë
- Studim projektim të objektit: ndërtim i ujësjëllësit të fshatrave të NJA Aranitas.

### ❖ Privatizime

Gjatë vitit 2022 nuk është paraqitur asnjë kërkesë për privatizim truall shtesë funksional sipas kritereve të VKM Nr.413 Datë 25.06.2014 “Për Përcaktimin E Kritereve e të Procedurave të Shitjes së Trojeve në Përdorim, Sipërfaqe të Domosdoshme, dhe Trojeve Shtesë Funksionale të Ndërmarrjeve Shoqërive Tregtare, të Objekteve Shtetërore të Veçuara, të Privatizuara, të Objekteve apo Ndërtesave të Shitura të Ish-Kooperativave Bujqësore, si dhe të Ndërtesave të Ndërtuara në Bazë të Lejeve të Ndërtimit” dhe as kërkesë për konfirmim genplani nga Dega e Shoqërive Publike bazuar ne VKM Nr.926 datë 29.12.2014 “Për Kriteret e Vlerësimit të Pronës Shtetërore, që Privatizohet apo Transformohet, dhe Procedurën e Shitjes.”


❖ Shqyrtimi i procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve për leje drejtimi të lëshuara në shtete të huaja



Komisioni i shqyrtimit të lejeve të drejtimit për shkeljet e kryera nga drejtuesit e mjeteve që zotërojnë leje drejtimi të lëshuara në një shtet të huaj bazuar në Ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe Ligjin nr.8378 datë 22/07/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” kanë trajtuar në total 16 procesverbale të konstatimit të shkeljeve për leje drejtimi të lëshuara në shtete

te huaja. Vihet re një rënie e ndjeshme e numrit të drejtuesve që shkelin ligjin . më poshtë një tabelë krahasuese e 5 vjecarit të fundit.

Viti \ Masa	2018	2019	2020	2021	2022
Alkol	77	25	14	4	4
Shpejtësi	176	53	38	151	12
Konvertim	-	1	2	3	0
Të tjera	1	1	0	3	0
<b>Total</b>	<b>218</b>	<b>79</b>	<b>54</b>	<b>158</b>	<b>16</b>



*Realizuar*

#### ❖ Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura

Janë mbajtur 2 mbledhje të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura për Parkun Kombëtar Divjakë - Karavasta.

Është analizuar puna e Administratës së Zonës së Mbrojtur Parku Kombëtar Divjake Karavasta si dhe janë trajtuar problematika të ndryshme si çështja e dezinfektimit, mosmarrëveshjet institucionale me bashkinë dhe AdZM , peshkimin e qëndrueshëm etj, te cilat janë ndjekur nga ana e Komitetit të Menaxhimit.

Në mbledhje gjithashtu është analizuar dhe ecuria e Projektit JICCA, për të cilin është mbajtur edhe një seminar në Tiranë datë 09.11.2022 ku u vlerësua puna e këtij projekti dhe kontributi që ka sjelle për zonën e mbrojtur .

Është mbajtur edhe mbledhja e KPK – Komitetit të Përbashkët Koordinues nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Fier në cilësinë e Kryetarit te Komitetit të Menaxhimit dhe me përfaqësues të AKZM, AdZM dhe autoritet japoneze të projektit JICCA të cilët e ndoqën mbledhjen online.

#### **Problematikat e trajtuara :**

Aktivite me mjedisore me synim shtimin e siperfaqeve te gjelbra

Bimësia e larmishme



Ndotja e Ujrave nga përdorimi i mjeteve motorrike

Siguria në zonën e mbrojtur

Peshkimi i qëndrueshëm dhe problematikat që e shoqërojnë

Ruajtja e biodiversitetit

Turizmi sezonal /gjithëvjeter

Kripëzimi i ujit të lagunës dhe komunikimi me detin


Menaxhimin e zonës së mbrojtur

Kolmatimi dhe abrazioni i vijës bregdetare




❖ Masterplani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane Qarku Fier

## QARKU FIER



Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të Qarkut i depozitojnë mbetjet në impiantin e trajtimit. Sasia e mbetjeve vjetore të depozituara për gjatë njësitë e qeverisjes vendore është si më poshtë :



#### ❖ Aksioni i Pastrimit të Qarkut Fier

Me Urdhër të Prefektit Nr.49 datë 25.11.2021 është ngritur grupi i punës ndërinstitucional për marrjen e masave për pastrimin dhe higjienizimin e mjedisit nga mbetjet në qark dhe gjatë muajit Nëntor ka pasur një aksion masiv nga gjashtë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Janë ndjekur raportimet ditore, është përgatitur materiali hartografik me pikat e nxehta sipas planit të masave dhe bazuar në aksion kombëtar “ SHQIPËRIA E PASTËR”. Aksioni i pastrimit vazhdon me një monitorim periodik nga ana e Institucionit të Prefektit me plane javor dhe raportime mujore. Gjatë vitit 2022 i është kushtuar një vëmendje e madhe pastrimit!

Janë zhvilluar aksione pastrimi në bregdet , në pyll, në zona rurale dhe kryesisht me nxënësit e shkollave me synimin e ndërgjegjësimit qytetar.



#### ❖ Pastrimi i hapësirave publike

Përpos Aksionit të pastrimit që është ngritur në muajin Nëntor, Njësitë e Qeverisjes Vendore vazhdojnë pastrimin rutinë të *hapësirave publike, parqeve dhe akseve rrugore* dhe raportojnë në mënyrë periodike. Ditën e premte të çdo jave realizohet edhe pastrimi i kunetave në qytete dhe fshatra, që janë një masë parandaluese në rast të përmytjeve. Vlen të theksohet puna e tyre në eliminimin e vendgrumbullimeve të jashtëligjshme edhe pse ka ende punë për të bërë.

#### ❖ Akset rrugore

Sektori i Zhvillimit Urban është angazhuar në përditësimin e Arkivit Kombëtar të Rrugëve. Sipas VKM Nr.600 datë 13.10.2021 “Për Pronësinë e Rrugëve Shtetërore dhe Kalimet e Pronësisë Ndërmjet Enteve Pronar të Rrugëve” ka ndryshuar matrica kilometrike e akseve rrugore që kalojnë në pronësi të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Për Qarkun Fier janë **21 akse rrugore** që ndryshojnë pronësi dhe në zbatim të kësaj VKM, në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore janë përmbledhur dhe përditësuar koordinatat dhe distancat kilometrike të akseve rrugore ndërqytetëse:

nga qendrat e qyteteve deri në pikë takimet e tyre me akset kombëtare për 24 akse rrugore. Sa i përket akse urbane brenda qarkut raportohet se gjendja është relativisht e mirë dhe njësitë vendore kujdesen për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin.

❖ Strehimi

<b>Bashkia Fier</b>	<b>Bashkia Lushnje</b>	<b>Bashkia Mallakastër</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• 2 programe strehimi : - subvecion qeraje -25F - subvencion i kërkesave të kredisë 26 F</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• bonus qeraje: -65 familje</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Projekti : Përmirësim i kushteve të banimit për komunitet të pafavorizuar</li></ul>
<b>Bashkia Patos</b>	<b>Bashkia Divjakë</b>	<b>Bashkia Roskovec</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• rikonstruksion i banesave te 20 familjeve ne nevojeka</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• permiresimi i banesave ekzistuese të familjeve në nevojë.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përmiresimi i banesave ekzistuese të familjeve ne nevojë!</li></ul>

## IV. MBROJTJA CIVILE

Veprimtaria e institucionit të Prefektit në drejtim të mbrojtjes civile është fokusuar në marrjen e masave për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë dhe përgjigjen për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë e tjera me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, të pronës, trashëgimisë kulturore si dhe mjedisit. Për këtë janë organizuar mbledhjet e KECQ “Për marrjen e masave për përballimin e situatave të mundshme të shkaktuara nga përmbytjet”. Janë hartuar dhe rifreskuar: Plani i Përballimit të Emergjencave në nivel Qarku; Plani Evakuimit; Plani i Gatishmërisë me skenar për përmbytjet; Plani i bashkëpunimit të strukturave monitoruese, vepruese dhe operacionale dhe janë përditësuar pikat e kontaktit, mënyrat e marrjes së informacionit dhe shkëmbimin e ndërsjellët me të gjitha institucionet qendrore dhe lokale.

Janë përcaktuar dhe evidentuar burimet dhe kapacitetet njerëzore dhe logjistike që disponon qarku dhe çdo drejtori në nivel qendror dhe lokal si dhe janë përcaktuar parashikimet e dëmeve të, janë përcaktuar kërkesat për mbështetje logjistike nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile.

I është kushtuar vëmendje ndjekjes konkretisht në terren të dinamikës së krijuar për shkak të emergjencave si dhe koordinimit dhe mbështetjes së strukturave, anëtare të KECQ, për normalizimin e situatave të krijuara nga reshjet e shiut, dhe të emergjencave verore.

Vëmendja kryesore në fushën e emergjencave civile ka qenë evidentimi dhe ndjekja e masave parandaluese për emergjencat civile në nivel qarku dhe ndjekja e ritmikës së realizimit të tyre si dhe angazhimi i strukturave operacionale nëpërmjet koordinimit të Prefektit në rastet e situatave emergjente të krijuara, kryesisht gjatë periudhës së verës. Vlen të theksohet fakti i padiskutueshëm i vijimit të rolit dhe vëmendjes së treguar nga Qeveria Shqiptare në fushën e mbrojtjes civile, nëpërmjet:

Thirrjes për aplikim për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në programin “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive”, program nga i cili;

Bashkia Fier ka përfituar një projekt për ndërtimin e paneleve mbrojtës përgjatë krahut të djathtë të lumit Vjosa.

Bashkia Roskovec ka përfituar një projekt për riparimin e shkarjes së rrugës dhe ruajtjen e pjesës tjetër të sajë nga shkarjet, në fshatin Ngjegjar, Njësia Administrative Kurjan.

Transfertes për përdorim të fondit prej 83,223,700 lekë, nga buxheti i shtetit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, për 6 (gjashtë) bashkitë e qarkut Fier.

Mirëmbajtjes dhe Investimeve të bëra nga Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit Fier si;

Investimeve për mirëmbajtje të sistemit të kullimit në kanalet e ujërave të larta në një gjatësi prej 20 km/ linear, në nivel qarku.

Investimit për mbrojtjen nga gërryerja në krahun e djathtë të lumit Vjosa me një gjatësi prej 400 ml, e cila mbron nga përmbytja një sipërfaqe prej 1000 ha.

Rikonstruksionit të Hidrovorit të Fierit dhe Karavastasë, Divjakë, të cilët kullojnë një sipërfaqe prej 12000 ha tokë bujqësore të zonës së Divjakës dhe Fierit.

Gjithashtu, nga Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile gjatë vitit është punuar edhe për përmbushjen e objektivave vjetor sektorial të përcaktuara që në fillim të vitit 2022 si; Konsolidimi i performancës së strukturave të mbrojtjes civile, planëzimi i emergjencave si dhe organizimi e pjesëmarrja në aktivitete në fushën e mbrojtjes civile.

### **Konsolidimi i performancës së strukturave të Mbrojtjes Civile**

Objektivi është realizuar nëpërmjet **konkretizimit e rritjes së forcimit dhe të bashkëpunimit** ndërmjet strukturave vendore dhe atyre qendrore, me rolin e institucionit të Prefektit si koordinuesi kryesor.

Gjithashtu, falë koordinimit të bërë nga institucioni i Prefektit gjatë sezonit pranverë – verë është rritur ndjeshëm **bashkëpunimi** i strukturave operationale në nivel vendor ( MZSH-të) duke i ardhur në ndihmë njëra – tjetrës për përballimin e situatave të shkaktuara nga zjarret gjatë periudhës së verës, në veçanti strukturat e MZSH-së Roskovec dhe Patos, në mbështetje të strukturave të bashkive të tjera.

Për realizimin e objektivit, Prefekti;

Në kuadër të koordinimit dhe bashkëpunimit efektiv ka zhvilluar me strukturat vendore të Mbrojtjes Civile përgjatë sezonit pranverë- verë 6 takime me fokus rritjen e gatishmërisë dhe të bashkëpunimit midis strukturave apo edhe çështje të tjera mbi përballimin e situatës së nxehtë të verës.

Ka kryer vizita inspektuese në 5 stacionet e shërbimit zjarrfikës në bashkitë e qarkut Fier. Duke vlerësuar rëndësinë e situatës ka marrë pjesë drejtpërdrejtë në 11 ngjarje emergjente. Nën koordinimin e Prefektit, referuar kërkesës së bashkisë Patos, kemi angazhuar në një rast forcat operationale të bashkive të qarkut fqinj, Berat me dy mjete zjarrfikëse dhe 10 efektivë si dhe në nivel qendror angazhimin e një helikopteri të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Rëndësi dhe rol të veçantë për konsolidimin e performancës së strukturave të mbrojtjes civile kanë patur edhe 3 mbledhjet e organizuar të Komisionit të Mbrojtjes Civile , Qarku Fier, si struktura vendore kryesore në fushën e mbrojtjes civile.

Gjithashtu, me krijimin e grupit të Whatsapp-it “ Komisioni i MC, Fier 2022” është standardizuar dhe strukturuar mënyra e raportimit mbi situatat emergjente në nivel qarku.



*Mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile*

#### **Konstatim:**

Në disa raste shkëmbimi i informacionit ka qenë i vonuar, jo i plot, kjo si pasojë e mosfunksionimit në nivelin më lart të bashkëpunimit të brendshëm midis strukturave të MZSH-ve dhe strukturave të E. Civile në bashki.

#### **4.2 Planëzimi i emergjencave civile**

Aktualisht, institucioni jonë punon mbi Planin e Qarkut të Emergjencave Civile i miratuar në vitin 2017. Plani aktual i Emergjencave Civile në qark (2017), është përditësuar vazhdimisht në lidhje me çdo ndryshim të ndodhur në lidhje me funksionet, strukturën dhe pikave të kontaktit të qendrave apo personave që kanë rol në menaxhimin e situatave emergjente.

Për menaxhimin e situatave emergjente, në përputhje me Planin e Qarkut të Emergjencave Civile përgjatë viti janë miratuar:

Plani për reagimin ndaj ndotjeve detare nga hidrokarburet e lëndët kimike, shkalla 2  
Plani i masave parandalimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen nga situata e mundshme të krijuara si pasojë e temperaturave të larta.

Plani i veprimit, për radhën e punës dhe procedurat që do të ndiqen nga Sektori i E.C në rastet e rënies së zjarreve masive në pyje dhe kullota.

Plani masave për përbalimin e sezonit vjeshtë – dimër 2022.

Përditësimi i sistemit të alarmit.

Në përmbushje të detyrime ligjore të përcaktuara në ligjin Nr. 45/2019 “ *Për Mbrojtjen Civile*”, 6 ( gjashtë) bashkitë e qarkut Fier në kuadër të hartimit dhe miratimit të dokumenteve për

“Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë” janë përzgjedhur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ( AKMC) si bashki-të pilot që do përfitojnë hartimin nga ekspertët kombëtar materialet, për:

Vlerësimin e Riskut në nivel vendor

Strategjinë e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë, në nivel vendor.

Planin për Emergjencat Civile, në nivel vendor.

Në kuadër të procesit të hartimit të dokumenteve strategjike për “ Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë”, konkretisht, në hartimin e dokumentit të “ Vlerësimit të Riskut” në nivel vendor për 6 ( gjashtë) bashkitë e qarkut Fier, Prefekti i Qarkut Fier ka patur një rol thelbësor në proces, për realizimin e të cilit:

Është koordinuar puna e strukturave vendore me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe ekspertët kombëtar të përzgjedhur për hartimin e dokumenteve.

Është ngritur dhe funksionin Sekretariati Teknik në nivel qarku.

Janë mbledhur, përpunuar dhe dërguar informacion sipas kërkesave të ardhura nga ekspertët e hartimit të dokumentit të vlerësimit të riskut apo AKMC.

Janë organizuar disa takime me pjesëmarrje të strukturave përgjegjëse në proces dhe grupeve të interesit.

Janë kryer inspektime në terren së bashku me ekspertin kombëtar në lidhje me identifikimin e riskut teknologjik.

*Nga takimi me ekspertet e hartimit të Dok.V.R Teknologjik dhe grupet e interesit*





## **Konstatim:**

**Objektivi është duke realizuar** për shkak se nuk janë miratuar ende dokumentet në nivel qarku për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, siç janë:

Dokumenti i Vlerësimit të Riskut  
Strategjia e Menaxhimit të Riskut  
Plani i ri i Emergjencave Civile, në nivel qarku.

Realizimi dhe përmbushja e këtij objektivi varet drejtpërdrejtë nga ecuria e procesit të miratimit të dokumenteve strategjik në nivel qendror si dhe hartimit e miratimit të dokumentit të Vlerësimit të Riskut në nivel vendor.

### **4.3 Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete në fushën e mbrojtjes civile.**

Realizimi i këtij objektivi është realizuar në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të mbrojtjes civile në nivel vendor dhe qendror nëpërmjet:

#### **4.3.I Pjesëmarrjes në aktivitete:**

Më datat 16 – 17 Shkurt 2022 pjesëmarrës në seminarin e organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar me temë “ Shëndeti në Emergjencë Civile”, Fier.

Më datat 8 -10 Mars 2022 pjesëmarrës në kuadër të programit IPA për përmbytjet dhe zjarret (IPA FF) i drejtuar në rang kombëtar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Tiranë.

Më datë 14 Prill 2022, pjesëmarrës në takim lidhur me zhvillimin e procedurave për integrimin e paralajmërimit të hershëm në planet vendore dhe qendrore për emergjencat civile, Tiranë.

Më datë 26 Prill 2022, pjesëmarrës trajnimin me teme: "Plani i masave dhe organizimi i grupeve të punës në terren , për reagimin ndaj ndotjes detare shkalla I dhe II, vlerësimi i derdhjes si dhe impakti në shëndetin publik", Vlorë.

Më datë 19 – 20 Dhjetor, pjesëmarrës në Workshopin me temë "Avancimi i planifikimit të Shqipërisë për përshtatjen afatmesme dhe afatgjatë ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet zhvillimit të një procesi të planifikimit kombëtar”



*Në kuadër të programit IPA për përmytjet dhe zjarret (IPA FF)*

#### **4.3.II Organizimit të aktiviteteve**

Më datat 23-24 Qershor 2022 u organizua ushtrimi simulues, me pjesëmarrës Prefektura Fier, Bashkia Fier, IGJEO dhe AKMC. “Për testimin e zinxhirit të komandës dhe të kontrollit dhe funksionin e komunikimit midis të gjithë aktorëve të përfshirë në Sistemin ekzistues të Paralajmërimit të Hershëm në rastin e një skenari përmytje, nga niveli kombëtar në atë lokal”, Tiranë-Fier.

Më datë 30 Qershor 2022 u organizua ushtrimi simulues me pjesëmarrje të Prefekturës Fier, bashkisë Fier, MZSH Fier, TAP-it dhe AKMC. “Për menaxhimin e një situatë të mundshme të rrjedhjes së gazit në tubacionin e TAP”, Fier.

Më datë 12 Tetor 2022, në pararendje të “Ditës ndërkombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë” në ambientet e Institucionit të Prefektit Fier, në bashkëpunim me DAR Fier, u organizua aktiviteti sensibilizues nëpërmjet 35 pikturave të realizuara nga nxënës të shkollave 9-vjeçare të qarkut Fier, nën moton “Paralajmëro, Vepro, Parandalo”

Më datë 13 Tetor 2022, në kuadër të “Ditës ndërkombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë” në ambientet e shkollës “Jakov Xoxa”, Institucioni i Prefektit në bashkëpunim me strukturat e Mbrojtjes Civile në bashkinë Fier, organizuan një aktivitet sensibilizues në fushën e mbrojtjes civile



*Nga “ekspozita” e nxënësve të shkollave 9 – vjeçare, qarku Fier*



*Nga prezantimi sensibilizues në shkollën “ Jakov Xoxa*

**Detyra të tjera të realizuara:**

Përditësimi i dosjes me aktetet ligjore dhe nënligjore.

Rifreskimi i plan masave për sezonin pranverë – verë dhe vjeshtë – dimër.

Përditësimi i bazës së të dhënave mbi situatat e zjarreve.

Hartimi dhe konceptimi i shkresave, informacioneve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore, etj.

Veprimtaria e Task-Forcës “ Për luftën kundër kultivimit të Kanabisit.

Koordinim i forcave operationale në nivel qarku në situata emergjente.

Asistim mbi verifikimin i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ mbi shpërndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar nga buxheti i shtetit.

### Emergjencat e ndodhura

#### Zjarre

Gjatë vitit 2022 në territorin e qarkut Fier, bazuar në të dhënat e raportuara nga strukturat vendore të Mbrojtjes Civile, janë evidentuar gjithsej 210 raste zjarri.

*Shpërndarja e rasteve të zjarreve sipas Nj.V. Vendore dhe dëmet e shkaktuara*

Emërtimi NJ.V.Q. V	Raste Gjithsej	Objekte			Sipërfaqet e veshura me bimësi						Depozit a bari per blektori ne	Automjete
		Rastet	Private	Publike	Rastet	Pyje		Ullishte		Sip.t ë dierr a		
						Rastet	Siper f. e Dieg ur (në ha)	Rastet	Sasia e Dieg ur (në rrënj ë)			
Qarku Fier	210	50	47	3	150	8	23.5	47	1052 3	95	7	3
Bashkia Fier	79	28	25	3	49	4	15	21	3778	24	2	0
Bashkia Lushnje	56	8	8	0	47	1	3	17	4795	29	1	0
Bashkia Mallakas ter	24	3	3	0	19	0	0	3	400	16	1	1
Bashkia Patos	18	5	5	0	13	1	0.5	5	850	7	0	0
Bashkia Divjake	10	1	1	0	8	1	2	1	500	6	1	0
Bashkia Roskove c	23	5	5	0	14	1	3	0	200	13	2	2


Në objekte 50 raste, nga të cilat 47 objekte private dhe 3 raste në objekt publik.

Në sipërfaqet e veshura me bimësi patëm 150 raste, nga të cilat 8 raste në pyje, 47 raste në ullishte dhe 95 në sipërfaqe të djerra private me shkurre, ferra e barishte.

Në depozita bari të thatë për bagëti 7 raste.

Në automjete 3 raste.

### *Rastet krahasimore 2021-2022 për çdo Njësi të Vetëqeverisjes Vendore*



Në raport me vitin 2021 kemi një tendencë në rritje të rasteve të zjarre në numra të përgjithshëm (30 raste). Kjo rritje më së shumti evidentohet në territorin e bashkisë Lushnje me 20 raste.

#### **Konstatime:**

Infrastruktura rrugore në drejtim të pyjeve/maleve apo zonave kodrinore me ullishte ka qenë jashtë funksioni apo ka munguar plotësisht.

Strukturat e M.C së bashkive në shumë raste nuk realizuan do të angazhimin e strukturave të tjera të bashkisë të planëzuara prej tyre, në mbështetje të MZSH-së, për vënin nën kontroll të situatës para se zjarri të rriste përmasat e tij.

Mbetet problem sensibilizimi i duhur i fermerëve, si për rrezikun që mund të sjell dalja jashtë kontrollit e ndezjes dhe përdorimit të zjarreve për djegien e mbeturinave në parcelat e tyre, si dhe për dëmtimin strukturor dhe varfërimin e fuqisë prodhuese të tokës bujqësore.

Repartet e MZSH-ve në përgjithësi janë të pakompletuara me stacione qëndrimi, personel, apo pajisje të tjera logjistike, çka ul ndjeshëm forcën e tyre reaguese.

Përgjatë rrjedhës së lumenjve në qarkun Fier, mungojnë pajisjet teknike/teknologjike për matjen e nivelit/prurjeve që do ndihmonte në situatat emergjente pozitivisht në realizimin sa me efikas të paralajmërimit të hershëm dhe njoftimit të komuniteteve të rrezikuara.

## **PROBLEMATIKA**

### **Në fushën e emergjencave civile**

Në pjesën më të madhe të rasteve të zjarreve, sidomos në sipërfaqet me ekonomi pyjore, **kemi të bëjmë me veprimtari të pastër kriminale, me qëllime dhe interesa të caktuara.** Zbulueshmëria dhe vënia përpara përgjegjësisë ligjore personave zjarrvënës ka qenë e ulët. Strukturat Vendore të Policisë, duhet të rrisin bashkëpunimin me strukturat e bashkive, për emergjencat në tërësi e tyre dhe në veçanti për parandalimin e zjarreve.

Është i domosdoshëm hartimi dhe nxjerrja e një akti ligjor, për ndalimin e ndezjes dhe përdorimit të zjarreve në sipërfaqet e veshura me bimësi dhe objektet me risk të lartë zjarri, gjatë muajve të verës..

Bashkitë duhet të marrin përsipër përgjegjësitë dhe të përmbushin detyrat e tyre ligjore, në kontrollin e territorit që kanë në juridiksionin e tyre, si dhe të rrisin dhe përmirësojnë kapacitetet reaguese, teknike dhe njerëzore të strukturave të M.C dhe MZSH-ve.

## **V. TASK FORCA, KOMITETET RAJONALE SI DHE ORGANI KËSHILLUES PRANË PREFEKTIT TË QARKUT**

### **KOMITETI RAJONAL I TURIZMIT**

Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve Qëndrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2022, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të vecanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjenes dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.

#### **Ky objektiv u realizua nëpërmjet:**

- Ngritjes së grupit të punës me anëtarë të degëve territoriale për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik.
- Drejtimi i Komitetit Rajonal të Turizmit

#### **Konkretisht :**

Për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik 2022, Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, i kushtoi një vëmendje të veçantë koordinimit dhe monitorimit të punës të Institucioneve Qendrore në nivel vendor që kanë impakt në mbarëvajtjen e sezonit, për këtë krahas punës së vazhduar gjatë

gjithë vitit me mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve Komiteti Rajonal I Turizmit me përfaqësues të drejtorive të Qarkut Fier si dhe me përfaqësues të nivelit qendror (Ministria e Turizmit) është mbledhur 2 herë përkatësisht në datat 25.02.2022 përpara fillimit të sezonit turistik si dhe në datën 27.06.2022. Në të dyja këto takime janë diskutuar tematika të rëndësishme të turizmit, çfarë duhej përmbushur përpara hapjes së sezonit turistik veror 2022, problematikat që mund të haseshin, çfarë mund të bëhej për ti zgjidhur përpara fillimit të punës, si dhe në takimin e fundit është diskutuar ecuria e punës, cilat janë problematikat të cilat ende nuk po gjejnë zgjidhje, janë sqaruar detyrat e përcaktuara në Urdhërin e Kryeministrit nr. nr.83 datë 11.05.2022 “Për ngritjen e Task-Forcës ndërinstucionale të sezonit turistik veror 2022” përfshirë “Plani i masave i miratuara për sezonin turistik veror 2022”. Nga ana e drejtorive të cilat kishin detyra specifike për turizmin u bë një raportim javor për menaxhimin e sezonit turistik, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier dhe ky raportim u përpunua dhe u raportua në Ministrinë e Brendshme çdo ditë të Premte.

### **VEPRIMTARIA E TASK-FORCE “ PËR LUFTËN KUNDËR KANABISIT”.**

Për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, ka vijuar ndjekja e veprimtarive të punës nga strukturat vendore si me bashkitë dhe Degët Territoriale dhe në mënyrë të veçantë me strukturat e DVP Fier.

Përgjatë vitit 2022 janë zhvilluar tre takime me pjesëmarrës të strukturave vendore pjesë e “ Task-Forcës Vendore”

Është bërë administrimi i planeve dhe informacioneve mujore ardhur nga bashkitë përkatëse mbi aktivitetin e tyre në luftën kundër kultivimit të kanabisit.

Në bazë të të dhënave të administruara nga Komunikatat e Policisë është përditësuar baza e të dhënave për rastet e kultivimit të kanabisit, si dhe referuar informacionit vjetor të DVP Fier, rezulton se për periudhën janar-dhjetor të vitit 2022, janë evidentuar **34** raste të kultivimit të kanabisit, janë evidentuar dhe asgjësuar **9881** bimë narkotike, janë implikuar **52** autorë, nga të cilët arrestuar **23**, shpallur në kërkim **11** dhe ndiqen në gjendje të lirë **18** autorë.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer gjithsej **35315** kontrolle në territorin e DVP Fier, nga të cilat; kontrolluar **22831** sera, **1499** magazina/objekte, **389** ish objekte ushtarake, **343** shtëpi të braktisura, **349** stane/stalla, **324** ish parcela dhe **6470** ambiente të hapura.

Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë duket një tendencë në ulje në lidhje me rastet e kultivimit të kanabisit të cilat paraqiten në tabelën më poshtë.

*Tabela për treguesit e luftës kundër kultivimit të kanabisit për vitet 2021-2022*

Antikanabis	Viti 2021	Viti 2022	Krahasimi
Vepra penale për kultivim	45	34	-11
Procedime proaktive kultivim	8	17	+9
Raste kultivimi të evidentuara	45	34	-11
Raste kultivimi zbuluar	34	34	---
Bimë të asgjësuara	<b>5040 ( gjithsej)</b>	<b>9881 ( gjithsej)</b>	+4841
Fidanë/kubikë të asgjësuara	3170 (kubik)	116 (kubik)	-3054
Vende kultivimi	49	35	-14
Proceduar autorë për kultivim	57	52	-5
Autore te arrestuar/ndaluar	41	23	-18
Proceduar kryeplak, insp. pyjor	5	0	-15
Numri i kontrolleve në territor-total	41016	35315	-5701
Serra te kontrolluara	37436	22831	-14605
Ambiente te hapura	1575	6468	+4895

## **ANTITRAFIKIMI E PERSONAVE NË QARKUN FIER ( KRAT )**

KRAT Fier e ka mbështetur punën e tij në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 6, datë 26.01.2017, “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Personave në çdo qark”, të VKM-së 670, datë 10.11.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023”, si dhe të VKM-së Nr. 400, datë 19.6.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të Planit të Veprimit 2019–2022”.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, nga KRAT Fier janë marrë të gjitha masat tekniko-organizative, operative dhe procedurale për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e personave apo grup personave, që tentojnë të kryejnë trafikimin e qenieve njerëzore brenda dhe jashtë vendit.

KRAT Fier ka zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjëse dhe informuese me shkolla dhe mjedise publike, në të gjithë territorin e bashkive të qarkut

Këto aktivitete janë kryer në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet DRAP, Shërbimin Social Shteteror, Drejtorisë Vendore të Policisë, strukturave pranë bashkive dhe aktoreve të tjerë. Aktivitetet kanë qenë të paracaktuara ose simbas rastit dhe problematikave të hasura.



Nga raportimet periodike prej institucioneve arsimore dhe shërbimit psiko-social pranë secilën zyrë vendore arsimore, rezulton se veprimtaritë në këtë kuadër janë planifikuar dhe realizuar në ndërthurje edhe me tematika të tjera, ose në të njëjtat plane integrale për luftimin e mbrojtjes së të rinjve gjatë lundrimit në internet, bullizmit, diskriminimit gjinor dhe edukimin ligjor të të rinjve. Aktivitetet janë zhvilluar me pjesëmarrjen kryesisht të nxënësve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë në shkollat e vartësisë, në to janë përfshirë edhe një numër prindërisht dhe mësuesish. Në përgjithësi, aktivitetet janë zhvilluar sipas planeve edukative të hartuara për secilën shkollë dhe të shërbimit psiko-social të njësisë vendore të arsimit parauniversitar përkatëse. Nuk ka pasur veprimtari të buxhetuara, por plani i aktiviteteve të shkollave në këtë kuadër, ose pjesëmarrja e nxënësve dhe mësuesve në aktivitete të organizatave partnere është kryer në përputhje me misionin dhe detyrimin që ka institucioni arsimor për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve. Në muajt maj-qershor 2022 është bërë një përmbledhje e punës në shkolla në zbatim të programit “Siguria e të rinjve”, mbi bazën e marrëveshjes nr. 831/1 prot., datë 7.2.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe nr. 1337/2 prot., datë 18.2.2022 Ministrisë së Brendshme. Në këtë kuadër janë përfshirë edhe seanca sensibilizimi për antitrafikimin e qenieve njerëzore, si edhe aktiviteti i oficerëve të sigurisë, të cilët janë në organikën e të gjitha gjimnazeve të mëdha në këto ZVAP. Në periudhën janar-maj, nëntor-dhjetor 2022 në 39 nga rreth 55 shkollat e **ZVAP Fier** janë trajtuar, në bashkëpunim me punonjësit e shërbimit psiko-social, si seminare dhe seanca njohëse, diskutime në klasa, si edhe në orë mësimore të caktuara, temat “grupet kriminale që trafiojnë njerëz nuk kursejnë as fëmijët”, “Të jemi vigjilentë ndaj fenomenit të trafikimit”, “Stop trafikimit të fëmijëve”, mbi mënyrën e informimit për rastet e dyshuara, linjat e komunikimit për ndihmë, etj. Në muajin tetor, në kuadër të veprimtarive masive antitrafik, në të gjitha shkollat janë organizuar konkurse me krijime grafike (vizatime, piktura) dhe letrare (ese, poezi) ku nxënësit kanë shprehur ndjeshmërinë e tyre ndaj këtij fenomeni kriminal. Për konkursin e pikturave me këtë temë, të organizuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, nga ZVAP Fier u paraqitën krijime grafike nga 90 nxënës.

Shkollat kanë bashkëpunuar, përveçse me Policinë e Shtetit, edhe me organizata si Qendra Sociale “Murialdo” (shkolla 9-vjeçare Zhupan, etj.).

Edhe në shkollat 9-vjeçare dhe gjimnazet e **ZVAP Patos** janë zhvilluar gjatë gjithë vitit 2022 takime informuese me nxënës ku janë trajtuar tema të njohjes së rrugëve të ligjshme për emigrim (lidhur me shmangien e mundësive të trafikantëve për të mashtruar viktimat e tyre), rreziqet e trafikimit dhe çfarë nënkupton trafikimi, cilat janë pasojat, informimin në kohë reale për rastet e trafikimit, etj. në këto veprimtari ku janë përfshirë të gjitha shkollat (8 institucione arsimore), janë angazhuar krahas mësuesve, edhe punonjësit e shërbimit psiko-social. Bashkia Patos ka ndihmuar në organizimin e këtyre aktiviteteve.

**ZVAP Roskovec** gjatë vitit 2022 ka orientuar shkollat e vartësisë për sensibilizimin e nxënësve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në programin vjetor kundër dhunës në shkollë. Gjithashtu shërbimi psiko-social ka zhvilluar takime informuese dhe aktivitete ndërjegjësuëse me nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Mësuesit e edukimit qytetar kanë trajtuar tema specifike për këtë çështje sociale në lëndën e tyre dhe mësuesit kujdestar kanë informuar nxënësit kundër luftës së trafikimit të qenieve njerëzore me tema të veçanta në orët kujdestari.

Në kuadër të veprimtarive për luftën kundër trafikimit të personave në shkollat e **ZVAP Lushnjë** janë realizuar seminare informuese dhe sensibilizuese me nxënësit e klasave të 9-ta dhe të gjimnazit në secilën shkollë ku vepron shërbimi psiko-social. Madje si temë është trajtuar në mbledhjet e qeverive të nxënësve në çdo shkollë të vartësisë së kësaj zyre. Veprimtaritë janë

zhvilluar në formë seminaresh informuese, takime sensibilizuese. Nxënësit kanë përgatitur gjithashtu postera me materiale të shkurtuara, vizatime e piktura dhe fletëpalosje.

Vlen të theksohet që në Shkollën 9- vjecare ‘‘Muhamet Shehu në Bashkinë Pato,s jane zhvilluar ore sensibilizimi dhe konsultimi me mesues kujdestare dhe koordinatorës se planprogramit per Trafikimin e Qenieve Njerezore gjate periudhes janar -dhjetor 2022 ne klasa te ndryshme te shkolles.Bashkepunetore te kesaj teme ka qene edhe inspektori i policise i cili ka njohur nxenesit rreth kesaj teme delikate.

Psikologia e shkolles dhe mesuesja koordinatorë ka kryer gjithashtu fushate sensibilizimi ne bashkepunim me nxenesit e Senatit te cilet kane marshuar me pankarta ne duar ne oborrin e shkolles dhe te qytetit duke dhene mesazhe kunder trafikimit.

**Në përmbyllje të kalendarit të aktiviteteve të muajit Antitrafikim për qarkun Fier , më datë 31.10.2022, nga ora 1000 deri në orën 11<sup>00</sup> në sheshin qendror tq qytetit Fier, u organizua dhe realizua Ekspozita Rajonale Antitrafikim e Qarkut Fier.**

Kjo Ekspozitë u organizua falë bashkëpunimit të frutshëm të Institucionit të Preektit me DRAP, dhe kjo nga ana e saj me Zyrat Vendore të Arsimit .

Ekspozita u realizua ne sheshin qendror të qytetit Fier, edhe pse ishin shumë dhe e bënte të vëhtirë në një ambient tjetër, por dhe për një ekspozim më të gjerë ndaj qytetarëve të qytetit dhe publikut në përgjithësi.

Në ekspozitë morrën pjesë , me pikturat e tyre, nxënësit më të talentuar të të qarkut Fier.

Në këtë takim u thirrën dhe morën pjesë, të gjithë anëtarët e Tryezës Teknike të Luftës kundër Trafikimit të Personave të qarkut Fier .

Në shenjë vlerësimi për kontributin e nxënësve Institucioni i Prefektit të Qarkut , përgatiti dhe shpërndau Certifikata mirënjohje për sejcilin nxënës me motivacionin:



*“Në vlerësim dhe mirënjohje, për kontributin e dhënë në fushatën e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit, për luftën kundër trafikimit të personave, përmes mesazhit të dhënë nëpërmjet artit të pikturës, si pjesëtar i grupit të nxënësve, që realizuan Ekspozitën e Pikturave Antitrafikim të qarkut Fier, në datë 31.10 2022.”*



Në datën 28.03.2022, në sallën e mbledhjeve në Institucionin e Prefektit Qarku Fier, u zhvillua takimi i Komitetit Rajonal Antitrafik (KRAT) Fier dhe Tryezës Teknike (TT) në funksion të tij, me axhendë;

- *Miratimi i Rregullores së KRAT Fier*
- *Miratimi i Planit Rajonal të Veprimt KRAT, për Qarkun Fier për vitin 2022.*
- *Miratimin i kalendarit të veprimtarive për KRAT Fier, 2022.*

*Dokumentet e sipërcituara dhe çdo material që shërben për luftën kundër Trafikimit të Personave, me urdhër të Prefektit të Qarkut Fier, janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Prefektit të Qarkut <http://prefektifier.gov.al/> tek menuja KRAT.*

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier në muajin Prill 2022 ka trajtuar rastin e një viktime me inicialet F.XH e moshës 35 vjeç, e martuar me tre fëmijë, banuese në Njësinë Administrative Cakran ,bashkia Fier, të cilësuar si “VMT”( viktim e mundshme trafikimi) bazuar në Procedurat Standarde të Veprimt mbi 18 vjeç. Pasi janë kryer të gjitha procedurat nga ana e DRSSHSSH-Fier dhe DVP-Fier viktimës i është ofruar mundësia e sistemimit të saj në një Qendër Rezidenciale për trajtimin e viktimave të trafikimit por ajo nuk ka pranuar, pasi kishte fëmijët minoren. Kërkesa e saj ishte punësimi i rregullt, pasi sipas

pretendimeve të saj shkaqet ekonomike e detyrojnë të kryej aktivitete të paligjshme “me dëshirën e saj” kundrejt pagesës.

*Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, nga informacioni i marrë nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, dhe nga gjitha strukturat e institucioneve të qarkut Fier, situata është si më poshtë:*

Trafikim i Personave të Rritur neni 110 i Kodit Penal, janë evidentuar **10 vepra penale.**

Trafikim i të Miturve, Neni 128/b janë evidentuar **4 vepra penale.**

Trafikim i personave të huaj neni 298 Kodit Penal, **8 vepra penale**

Për nenin 298 janë arrestuar **6 persona.**

**Rastet e tjera, janë në ndjekje në prokurorit e Fierit dhe Lushnjës .**

Strukturat e KRAT Fier janë të angazhuara në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, për të gjitha format e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar, duke kryer në çdo rast veprimet e procedurale dhe duke vënë përpara përgjegjësisë ligjore autorët.

Si pjesë e përmbushjes së detyrimeve tona ligjore, vazhdon puna për parandalimin, evidentimin dhe luftimin e këtij fenomeni duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave .

## VI. REKOMANDIME

Përmirësimi i mëtejshëm i punës dhe performancës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier kërkon përkushtim dhe angazhim gjatë këtij vitit nga administrata e Prefektit . Për realizimin e kësaj performance dua të rendit disa rekomandime, si më poshtë:

Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile si dhe me shoqata mjedisore për krijimin e një mjedisi të pastër brenda territorit të qarkut.

Respektimin e afateve kohore në raportimin periodik mujor të Degëve Territoriale, dhe pasqyrim të arritjeve sipas objektivave të vendosura mujore prej tyre si dhe problematikave

Përgatitja e planeve vjetore në përputhje me ligjin për Çdo Degë Territoriale dhe dërgimi i tyre pranë institucionit të Prefektit brenda muajit shkurt 2023

Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve duke shërbyer me profesionalizëm dhe me integritet moral si dhe shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke i adresuar drejt zgjidhjes ligjore brenda afateve kohore.

Rritja e performancës së punonjësve të administratës shtetërore brenda çdo institucioni apo degë territoriale.

Rritja e rolit të Prefektit në konsolidimin e imazhit të institucionit nëpërmjet menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Rritja e bashkëpunimit në Institucionin e Prefektit të Qarkut në mbështetje të personelit për përmirësimin e kushteve të punës si në aspektin jetësor ashtu edhe atë funksional sipas sektorëve dhe në tërësi për Institucionin e Prefektit.

Standardizimi i mënyrës së hartimit të urdhrat, shkresës, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, dorëzimit të dokumentacionit të prapambetur në AQV, ruajtja e dokumenteve shkresore, monitorimi i ecurisë së sistemit të dokumentacionit arkivor në vite

Rritja e bashkëpunimit midis Njërive të Vetëqeverisjes Vendore, Inspektorateve Shtetërore, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut me qëllim parandalimin dhe identifikimin e autorëve në veprat penale si zjarrvënien e qëllimshëm, kultivimi i lëndëve narkotike, prerja e pyjeve, etj.

Hartimi i Planit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në shkallë qarku, bazuar në ndryshimet ligjore e udhëzimet e ardhura nga AKMC, duke i kushtuar rëndësi të veçantë analizës së riskut, llogaritjes së forcave dhe mjeteve (të strukturave vendore, strukturave qendrore dhe të të tretëve) dhe skenarëve të ndryshëm sipas probabilitetit të ndodhjes.

## VII. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023

1-

**Rritja dhe konsolidimi i frymës institucionale gjatë procesit të verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ me organet e vetëqeverisjes vendore** duke synuar përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe përmirësimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut.

**Do të realizohet nëpërmjet:**

Verifikimi ligjor i akteve me karakter normativ nga ana e sektorit juridik si sektor përgjegjës në bashkëpunim me sektorët përkatës sipas natyrës së aktit normativ. Kryerja e verifikimit në vend të akteve me karakter normativ në mënyrë efektive dhe periodike duke garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi përsa i përket verifikimit ligjor të akteve. Zhvillimi i takimeve konsultative me kryetarët dhe sekretarët e këshillave bashkiak.

2-

**Përmbushja e funksioneve të Prefektit të parashikuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**(i ndryshuar) për konstituimin e organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore që do të krijohen nga zgjedhjet e 14.05.2023.

**Do të realizohet nëpërmjet:**

1. Hartimi i aktit për përcaktimin e numrit të anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e Prefektit të Qarkut, mbi bazën e numrit të banorëve, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet vendore.
2. Hartimi i aktit për përcaktimin e numrit të përfaqësuesve të çdo bashkie, që përfshihen në territorin e qarkut duke u bazuar në të dhënat e numrit të popullsisë, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit të zgjedhjeve vendore.
3. Përgatitja e thirrjes për mbledhjen e parë të këshillit bashkiak në mungesë të sekretarit të këshillit bashkiak
4. Ndjekja e procedurës gjatë mbledhjes së parë të këshillit bashkiak.
5. Ndjekja e procedurës së betimit të kryetarit të bashkisë.
6. Ndjekja e procedurës së konstituimit të Këshillit të Qarkut.

3-

**Zhvillimi i marrëdhënieve, midis Institucioneve të pavarura dhe Institucioneve të varësisë në Qark si dhe Institucioneve Qendrore të Qeverisë, Ministrisë, KM, etj me qëllim koordinimin e tyre për realizimin e objektivave qeveritare dhe strategjive të miratuara në drejtim të funksioneve në fushën e sigurisë publike, fushën e zhvillimit ekonomik vendor, në fushën e bujqësisë, natyrës dhe biodiversitetit, në fushën e kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese etj, si dhe**

në drejtim të kompetencave të deleguara pranë pushtetit vendor duke adresuar çdo pengesë dhe problematikë në zbatimin e detyrave.

#### **Do të realizohet nëpërmjet**

Punës për eliminimin e mbivendosjeve të kompetencave, Mbulimi i detyrave dhe kompetencave nga çdo organ publik kërkohet të jetë harmonik në mënyrë që atje ku mbarojnë kompetencat e një organi fillojnë kompetencat e organit tjetër, kështu çdo problematikë e hasur në ushtrimin funksioneve dhe kompetencave nuk ngel pezull por zgjidhet nga Institucioni i Prefektit ashtu siç e përcakton edhe pika 3 neni 19 i Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

**4-**

**Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve qendrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2023, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të veçanta për sezonin turistik** në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjienës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.

#### **Do të realizohet nëpërmjet:**

Bashkëpunimit me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për një sezon të suksesshëm turistik në Qark si dhe turizmin në përgjithësi gjatë vitit duke koordinuar veprimtaritë e Institucioneve të përfshira si NJVQV-të, ARRSH, DRTRR, ISHSH, NJVKSH.

**5-**

#### **Forcimi i kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes civile**

Do të realizohet nëpërmjet

- Rritja, përforcimi dhe standartizimi i veprimtarisë strukturave vendore të mbrojtjes civile

**6-**

#### **Hartimi i dokumentit të Vlerësimit të Riskut dhe Plani i Emergjencave në nivel**

qarku me qëllim:

- Përbushjen e detyrime ligjore të parashikuara në ligjin Nr. 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile” dhe plotësit me setin e domosdoshëm të dokumentacionit për “Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë”.

**7-**

#### **Organizimi i fushatave sensibilizuese, pjesëmarrja në aktivitete apo trajnime në fushën e mbrojtjes civile**

Do të realizohet nëpërmjet:

- Ndërgjegjësimi të qytetarëve në raport me emergjencat civile.

- Promovimit dhe konsolidimit të veprimtarisë së strukturave të mbrojtjes civile.

**8-**

#### **Ndjekja e zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore për gjashtë bashkitë e qarkut :**

**Fier, Lushnje, Mallakastër, Divjakë, Patos, Roskovec.**

Do të realizohet nëpërmjet:

Ndjekjes së ndryshimeve të PPV (Planeve të Përgjithshme Vendore ) dhe zbatimi nëpërmjet PDV (Planeve të Detajuara Vendore )

Hartimi i një programi *TRACK PPV* për të ndjekur ecurinë e Planeve Vendore në disa pika kyçe!

Gjurmimi i shtimit të sipërfaqeve të gjelbra , këndet e lojërave për fëmijë, qasjet me ndryshimet klimaterike!

**9-**

**Ndjekja e Aksionit te Pastrimit për gjithë Qarkun Fier !**

Do të realizohet edhe nëpërmjet:

Inicimi i një projekti për riciklimin e letrës !

Studimi plastikës dhe riciklimi!

**10-**


**Ndjekja e procedurës me Ministrinë e Financave për privatizimin e trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare të objekteve shtetërore të veçuara të Privatizuara të objekteve apo të ndërtesave të shitura të ish-kooperativave bujqësore si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit”.**



## **VIII. BURIMI I INFORMACIONIT**

1. Informacioni i marrë nga dokumentacioni i prodhuar nga sektorët e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier
2. Raportimet nga 6 bashkitë e qarkut Fier.
3. Raportim nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.
4. Raportimet nga Degët Territoriale që veprojnë në qarkun Fier.





**NGA 2022**

**VJOSA PARK KOMBËTAR**